Smith et al. 1979, 1984 etj., emermin "baseni oqeanik Pindi" e kane perdurur ne trajtimet regionale per te treguar zgjerimin oqeanik ne perendim te platformes Pelagoniane. Papanikolaou 1989, si vend te zgjerimit oqeanik konsideron basenin Pindi - Cyklade, bile autorri i mesiperm edhe ne jug te fjalës transformuese Sperchio zonat Parnase dhe Beotiane i trajton si treva lindore te basenit oqeanik Pindi - Cyklade (fig. 2). Pozicionin aktual te ofioliteve autorri e interpreton me shariatshim gjigand te tyre me drejtim lindor qe pasi branisen mbi zonen Parnase e Beotiane vendosen mbi zonen Pelagoniane. Jones et al. 1991, Robertson et al. 1991 jo vetem pranoje si vend te gjenezes se ofioliteve basenin oqeanik Pindi por si buze perendimore te ketij basenii vizatojne, ne disa rajone zonen Gavrovo (= Kruja) dhe ne rajone te tjera direkt zonen Jonike (fig.3). Ne dallim nga Papanikolaou 1989 autoret e mesiperm ne jug te fjalës transformuese Sperchio, basenin oqeanik Pindi e interpretojne edhe ne lindje te platformes Parnase. Afersiht te njejtin pozicion me Papanikolaou 1989 kane paraqitur edhe Le Ricou 1994, Dercourt et al. 1995 ne atlasin paleogeografik per trevat e Tetisit. Kohet e fundit keto interpretetime nga disa studjuesh janë shtrire direkt edhe per Shqiperine. Ne artikullin "Mesozoic - Tertiary tectonic evolution of Albania in its regional Eastern Mediterranean context", Robertson, Shallo 2000, vendin e gjenezes se ofioliteve te zones Mirdita e pranojne ne basenin Krashta - Cukali me buze perendimore platformen Kruja dhe buze lindore "Kompleksin Periferik" si pjese perberese te platformes Korab - Pelagoniane (fig.4,5). Ata perdonin edhe termin basen oqeanik Mirdita - Pindi duke bashkuar keshtu dy giera krejt te ndryshme. Ne kete menyre ato bejne nje adoptim artificial per Shqiperine te interpretimeve te hedhura me pare per Greqine (Jones et al. 1991, Robertson et al. 1991 etj.). Ne esence, ne baze te parashtrimeve te autoreve te cituar me siper zona Mirdita elemiñohet ose e shumta ajo identifikohet vetem me ofiolitet, te gjeneruara ne basenin Krashta - Cukali (= Pindi).

Sikunder eshte e njohur gjeresish, shumica dermonjese e studiuesve shqiptare me argumenta bazuar ne informacione te shumta geologjike si vend te gjenezes se ofioliteve te Shqiperise pranojne basenin oqeanik Mirdita dhe jo basenin Krashta - Cukali (= Pindi) Me poshte po rendsim disa trajtime kryesore lidhur me kete problem:

1. NE TROGUN KRASTA - CUKALI (= PINDI), NUK ESHTE ZGJERUAR BASENI OQEANIK ESHTE ZGJERUAR NE ZONEN MIRDITA

Zona Krashta - Cukali ne evolucionin e saj nga Aniziani i vonshem deri ne Terciar ka perfaqesuar nje basen me kore te holle kontinentale ku, pas nje riftingu te abortuar gjate Anizianit te vonshem qe shpreket me vulkanite intrakontinentale etj. kane vijuar depozitime pelagjike si gelqerore plakore me silicore, radiolarite dhe flishe (fig.6). Pozicioni i saj, ashtu siç e pranojne shumica e gjeologeve shqiptare eshte mes platformes Kruja ne perendim dhe platformes Hajmeli ne lindje. Asnjë e dhene direkte apo indirekte nuk deshmon qe gjate Anizianit te vonshem deri ne Terciar ne trogut Krashta - Cukali te jetë zgjeruar basen oqeanik dhe prejet kontinentale te zones Krashta - Cukali te kene perfaqesuar buze pasive te drejperdrejta te tij. E njejtë situate eshte edhe per trojet Pindi dhe Budva ne territoret Greke dhe Malazze. (fig.6). Interpretimin per nje basen oqeanik Krashta - Cukali (= Pindi) autoret e cituar me siper na e servirin si aksione, pa dhene as edhe nje argument. Fakti qe prejet e nenzones pelagjike Cukali paraqiten te vijueshme nga Triasiku i mesem deri ne Terciar (Xhomox, 1976, Xhomox, etj. 1975, Theodhori, 1988, Meço 1999, Meço, Aliaj, 2000, I.S.P.G.J. Gjallica platform, Qerret-Miliska and Mbasdeja basin/slope).

se zona Krasta - Cukali dhe Mirdita jane esencialisht te ndryshme nga njera tjetra. Gjithashtu, ne asnjë prejte te nenzones Cukali ne Shqiperi apo te zones Pindi ne Greqi, (Thiebault et.al. 1994) ne nivele te Jurasikut te siper apo Jurasiku - Kretakut nuk takohen formime te melanzhit "bloqe ne matriks", qe perfaqesojne formime tipike te prizmave te akreacionit. Kjo eshte nje deshmi se Krasta - Cukali dhe Pindi gjate asaj periudhe nuk jetonin situata te mbylljes se basenit oqeanik si buze kontinentale te drejtperdrejta. Ne te kundert, nje gje e tillë dokumentohet ne menyre te pote ne nenzonen Qeret - Miliska dhe Mbasseja qe perfaqesojne buzet kontinentale direkte (basene/shpatë) te basenit oqeanik Mirdita (fig.7). Edhe analiza e depozitimit te materialit copezor me prejardhje ofiolitike ne Albanide tregon qarte qe moshat me te hereshme (Jurasik i siper) te depozitimit te tyre Jane ne zonen Mirdita, mbi vete ofiolitet dhe buzet kontinentale te aferta te saj. Ne drejtim te perendimit, ne nenzonen Ostreni (= Gramozi) dhe me ne perendim, drejt nenzones Cukali mosha e tyre eshte gjithnjë e me e re. Per kete problem ne nje studim te specializuar qe i dedikohej teresisht sqaritmit te vendit te gjenezes se ofioliteve te masiveve te Vurinosit, Pindit, Othritit etj. autoret Thiebault et al 1994 kundershtojne interpretimet e Robertson et al. 1991 sipas te cilave, vendi i gjenezes se ofioliteve te masiveve te mesiperm eshte baseni Pindi. Thiebault et al. 1994 studjuan fraksionin argjilor ne sedimentet e dy baseneve te Helenideve te jashme: Pindi dhe Beotiane si dhe ne basenin Maljak te Hellenideve te Brendeshme. Kronologjikisht, dy autoret veçojne shoqerime te ndryshme argjilash ne sekuenca sedimentare te baseneve Pindi dhe Beotiane:

- a - *Shoqerimi i poshthem* dominohet nga shtresa Ilite dhe Ilite - Smektitë dhe te pastra nga Mg, Ni dhe Cr ; Ky shoqerim ka burime nga treva erozioni me natyre kontinentale;
- b - *Shoqerimi i sperm*, qe shfaqet ne Titonianin e vonshem dhe ndertohet nga Smektit trioktaedral (tipi Saponit), i pasur me Fe, Mg, Ni dhe Cr; me derivacion te sigurte nga treva ofiolitike. Studimi i shperndarjes ne kohe dhe hapsire te makro dhe mikro depozitimeve me material copezor ofiolitik tregoi qe materiali ofiolitik ka devijuar nga linda (zonat e brendeshme), drejt perendimit (zonat e jashme).

2. BUZET KONTINENTALE PASIVE TE BASENIT OQEANIK MIRDITA

Ne trajtimet e studiuesve Papanikolaou 1989, Jones et al. 1991, Robertson et al. 1991, Dercourt et al. 1995, Robertson, Shallo 2000 etj. si buze kontinentale lindore e basenit oqeanik Pindi (= Krasta - Cukali) merret platforma Pelagoniane (Korab - Pelagoniane), ndersasi buze kontinentale rendimore kryesish platforma Gavrovo (=Kruja). Mohohen keshtu teresisht nenzonen pelagjike apo platformike te zones Mirdita duke ja atribuar ato me pa te drejt zones Pelagoniane. Mendojme qe veçanerisht ne studimin e fundit Robertson, Shallo 2000, i cili trajton posaçerisht gjeologjine e Shqiperise, ky interpretim perfaqeson nje hap te madh mbrrapa duke injoruar arripte teper te rendesishme te studiuesve te Albanideve mbeshtetur ne informacione te shumta shkencore te terrenit dhe laboratorike. Pothuaje te gjithe studiuesit e Albanideve kane vene ne evidence pranine e zones Mirdita me ofiolitet dhe periferite e saj kontinentale dhe dy dekadat e fundit mjaft studiues Kodra, Gjata 1982, 1995, 1999, 2001, Kodra 1987, 1988, Godroli 1992, Hoxha 1995, 1996, Meço, Aliaj 2000 etj. kane argumentuar shkencersisht ndertimin e superzones Mirdita si nje strukturre e madhe grabenore me basenin oqeanik ne qender dhe dy buzet kontinentale pasive: basen / shpatë Qeret - Miliska dhe Mbasseja dhe platformat karbonatike Hajmeli e Gjallica ne periferi te struktura grabenore (fig.8).

Platorma Hajmeli shtrihet mes basenit pelagjik Krasta - Cukali (dhe Ostreni) ne perendim, dhe basen / shpatë Qeret - Miliska dhe basenit oqeanik Mirdita ne lindje. Ajo ka perhapje te gjere ne Shqiperi nga Shita e Hajmeli ne veri deri ne Leskovik ne jug. Si vazhdimesi e nenzones Hajmeli ne territorin Grek mendojme se eshte njësia platformike Kozikas - Trilofon. Robertson dhe Shallo 2000, nenzonen Hajmeli e perfshi ne "Kompleksin Periferik", te cilin e interpretojne si buze perendimore e platformes Korab - Pelagoniane, e demaskuar tektonikisht sipas tyre ne perendim te ofioliteve. Kete interpretim megjithese parashtronet per here te pare ne literaturen gjeologjike per Shqiperine autoret na e servirin te gatshem, pa e mbeshtetur ne as edhe nje te dhene te terrenit, nederkohe qe njeri prej autoreve ashtu si dhe studiuesit e tjete te Albanideve per vite e vite me rrade ka mbrojtur pikpamje krejt te kundert me sa me siper. (Shallo etj. 1980, 1994, 1995 etj). Edhe

studjuesit me te hershem (Biçoku, Papa 1965, Biçoku etj.1970) ne trajtimet paleogeografiqe ne perendim te ofioliteve pranonin nje platforme karbonatike, te cilën me vone e kemi emrtuar Hajmeli (Kodra 1987). Mendojme se informacioni i shumte gjeologjik nga Shqiperia mbeshtet vetem variante te interpretimeve per pozicion te nenzones platformike Hajmeli ne perendim te basenit oqeanik Mirdita (Kodra 1987, 1988, Kodra, Gjata 1982, 1999, 2000, Kodra etj. 1993, 1995, 1996, 2000, Godroli 1992, Hoxha 1995, 1996 etj.).

Ne nenzonen Hajmeli, gjate gjithe perhapes madheshtore te saj nuk evidentohen ne asnjë rast ofiolitike nga baseni Krasta - Cukali ne drejtim te lindjes per qindra kilometra. Ne te kundert, paleostrukturat e nenzones Hajmeli (para mosperputhjeve strukturore te Titonianit te vonshem dhe te Barremianit) kane vetem vergjence te qarte perendimore. Nje situate e tillë vrojtohet ne Shiten e Hajmellit, ne malin e Veles, ne malin e Sinanit etj. (Kodra 1987, 1988, Godroli 1992, Hoxha 1995, Hoxha. 1996, Dimo 1997 etj). Ne Fierze te Rubikut (Kodra etj.1996, 2000) flishi "Fierza" i Titonianit te siperm.- Valanzhianit mbulon me mosperputhje strukturore te theksuar si strukturat e deformuara te buzes kontinentale perendimore ashtu dhe te ofioliteve te braniusura mbi to nga linda ne perendim (Godroli 1992, Carosi et.al.1996 etj.).

Me konceptumin e "Kompleksit Periferik" si buze perendimore te zones platformike Korab - Pelagoniane, Robertson, Shallo 2000 mohojne edhe pranine e basen / shpatëve Qeret - Miliska e Mbasseja si buze pasive te drejtperdrejta te basenit oqeanik Mirdita, por thjeshtë i trajtojne ato si disa thellime te izoluara intraplatformike pa asnjë rol ne gjeologjine e Albanideve.

Ne te vertete daljet me siperfaqe te kufizuara te nenzonave pelagjike Qeret - Miliska dhe Mbasseja ne periferi te ofioliteve te zones Mirdita perfaqesojne vetem nje pjese te vogel te ketyre nenzonave. Ato Jane te mbulaura gjerasisht nga napat ofiolitike Triasiku - Liasike dhe Jurasicke dhe demaskohen ne menyre fragmentare ne trajte dritaresh tektonike ne Kçire, Kaftalle, Vig, Fregen, Butem, Livadhas, Vataj, Alarup etj.

Edhe interpretimi mbi nje ballafaqim te drejtperdrejte te nenzones Valbona me basenin oqeanik ne jug te transformues Shkoder - Peje nuk eshte bindes dhe eshte me shume nje gjetje artificiale e autoreve qe buron nga trajtimi i gabuar qe i behet basenit oqeanik Mirdita si nje basen i gjeneruar ne zonen Krasta - Cukali.

Ne fig. 8 ne kemi paraqitur situaten gjeologjike gjate Jurasikut te mesem ne jug dhe veri te transformues Shkoder - Peje. Ne te paraqitet qarte se ofiolitet e Shqiperise dhe vazhdimi i tyre ne Greqi Jane formuar ne basenin oqeanik Mirdita dhe jo ne basenin Krasta - Cukali (= Pindi).

3. BASENI OQEANIK I MIRDITES ESHTE MBYLLUR GJATE JURASIKUT

Autoret Robertson, Shallo 2000 bëjne fiale per nje basen oqeanik te mbetur hapur ne Krasta - Cukal gjate Jurasikut, Kretakut e Terciarit te hershem dhe te mbyllur ne Eocen te vonshem (fig.5). Me asnjë te dhene direkte apo indirekte, ata nuk e mbeshtesin nje interpretim te tillë. Sipas ketij interpretimi duhej te printim qe ne basenin oqeanik te mbetur (hapur), te depozitoheshin sedimente te thella gjate gjithe intervalit nga Jurasiku deri ne Terciarin e hershem. Nje situate te tillë nuk e kemi te dokumentuar mbi ofiolite qofte edhe ne nje pike te vetme. Mendojme qe edhe per kete problem modelet e dhena per Greqine (Jones et al. 1991, Robertson et.al. 1991, Papanikolaou 1989) Jane te pa adoptueshme per Shqiperine. I gjithe informacioni gjeologjik e gjeofizik qe disponohet per Shqiperine flet qe, zona Krasta - Cukali nga Triasiku i mesem deri ne Terciar ka qene nje trog kryesish me depozitime pelagjike dhe ne zonen Mirdita ku eshte zgjeruar baseni oqeanik, mbyllja e tij eshte bere kryesish gjate Jurasikut te mesem - te vonshem, pra nuk ka patur basen oqeanik te hapur gjate Kretakut dhe Terciarit te hershem.

4. PALEOVENDOSJET INTRAOQEANIKE DHE MARGJINALE TE OFOLITEVE KANE QENE DY ANESORE

Studimet qe bejne sfale per nje basen oqeanik Pindi (= Krasta - Cukali) dhe pranojne vetem paleoshariazhe te ofioliteve jurasike ne drejtum te lindjes mbi mikrokontinentin Pelagonian nuk spjegojne edhe fakte teper te rendesishme te pranise se formacioneve oqeanike triasiku - liasike te perfaqesuar me Formacionin Vulkano - Sedimentar (bT₂ - J₁) si dhe te Shtrojes Metamorfike (hsJ₂) ne te dy krahet dhe ne dyshemet te ofioliteve Jurasike te zones Mirdita. Ata kane moshe e perberje te njeje dhe paraqesin deformacione me vergjence dyanesore ashtu si dhe formacionet e buzeve kontinentale mbi te cilat ato jane vendosur. Veten interpretimet me paleovendosje me vergjence dyanesore si gjate statit intraoceanic ashtu dhe marginal ne basemin e ngushte Mirdita spjegojne ne menyre te kenaqshme realitetin gjeologjik ne Albanide Brendeshme (Kodra, Gjata 1982 etj.). Prej shume vitesh ne kemi vete ne evidence se qjo paleovendosje eshte asimetrike, ku vendosja drejt lindjes eshte me e kufizuar se ajo drejt perendimit (Kodra, Gjata, 1982).

* * *

Argumentat e parashtrara me lart mbi vendin e gjenevezës se ofioliteve të zonës Mirdita dle pozicionit aktual të tyre në strukturën e Albaniave flasin qartë për paqendrueshmërinë e interpretimeve sipas të cilave ofiolitet e zones Mirdita e kanë gjenezën në basenin Krasta - Cukali. Në kuadër me regional ne harkun Dinaro-Albano-Helenid tabulloja e këtij degëzimi tetision paraqitet e tillë:

a. Ne segmentin ne veri te faljes transformuese Shkoder - Peje: Baseni i ngushte oqeanik Dinarik (Mirdita) eshte zgjeruar ne lindje te platformes se Durmitorit dhe ndahej nga baseni oqeanik i Vardarit prej mikrokontinentit Drina - Ivanica (=Korab - Pelagoni s.l.). Baseni me kore te holle kontinentale Budva (vazhdim i basenit Krasta - Cukali ne veri te faljes Shkoder - Peje) nuk ka asnjë lidhje me treven oqeanike dinarike.

b. Ne segmentin mes faljes transformuese Shkoder - Peje dhe Sperchio: Baseni oqeanik eshte zgjeruar ne strukturen grabenore Mirdita e cila ndahet nga trogu i Krasta - Cukalit (= Pindi) me ane te platformes Hajmeli (= Kosiakias - Trilofon). Ne zonen Krasta - Cukali dhe vazhdimin e saj ne Greqi, Pindi, nuk eshte zgjeruar ndonje basen oqeanik gjate Triasikut te mesem deri ne Terciar. Gjate periudhave te mesiperme Krasta - Cukali dhe Pindi kane ekzistuar si trog ku depozitoheshin sedimente pelagjike.

c. Ne segmentin ne jug te faljes transformuese Sperchio: Baseni oqeanik eshte zgjeruar ne lindje te platformes Parnase, trogut Beotian dhe platformes "Subpelagoniane". Edhe ne jug te Sperchios trogu me kore te holle kontinentale Pindi nuk ka lidhje me basenin oqeanik. Ne kete kontekst kuptohet edhe paqendrushmeria e emertimit "baseni oqeanik Pindi". Perdorimi i ketij emertimi per vendin e gjenezes se ofioliteve te harkut Dinaro - Albano - Helenid eshte i padreite, sjell konfuzion dhe orientim te gabuar tek studiuesit e ketij brezi. Per vete perpareste historike te emertimit te zones Mirdita (Nopcsa 1929 etj.) dhe faktit qe kjo superzone ku ofiolitet dhe formacionet e dy buzeve kontinentale kane perhapje madheshtore dhe ofrojne informacione gjeologjike te bollshme dhe bindese per vendin e gjenezes se ofioliteve dhe gjithe historine tektonike te tyre, emertimi "baseni oqeanik Mirdita" eshte teresish i motivuar.

ABSTRAKT

Ofolitet e Shqiperise (fig.1) dhe vazhdimi i tyre ne Greqi kane qene objekt i studimeve te shumta dhe veçanerist vendi i gjenezes dhe menyra e vendosjes se tyre ka njallur njaft debate. Ne kete diskutum do te ndalem i ne parashtrimin e argumentave shkencor qe deshmojne per paqendrushmerine e interpretimeve, sipas te cilave, vendi i gjenezes se ofioliteve te Shqiperise dhe vazhdimit te tyre ne Greqi eshte baseni Krasta - Cukali (= Pindi) dhe lidhur me kete do te shprehim mendimin tone edhe mbi perdonimin e emertimit "baseni oqeanik Pindi"

HYRJE

Ndërmjet ofioliteve të tipit SSZ të përhapura në pjesën lindore të zonës strukturalo - faciale Mirdita, vulkanitet mbajtëse të mineralizimeve sulfure kanë një peshë të konsiderueshme. Sektori Qafë Bari - Munelle është aktualisht pjesa më interesante e brezit të mineralizuar Qafë Mali - Spac, ku preja gjeologjike është më e plotë dhe mineralizimi sulfur prezantohet me disa veçori njaft të spikatura. Punimet e shumta të kërkim - zbulimit të kryera në këtë sektor kanë bërë të mundur që të grumbullohet një informacion i shumtë dhe i hollësisht përmes mineralizimit sulfur në lidhje me mardhëni e tij me shkëmbinjte rrethues, morfoljinë e trupave, zonalitetin etj. Në të njëjtën kohë është bërë e mundur të qartësohet më tej preja e vulkaniteve, tektonika rudosëse, ajo shkëputëse etj. Lidhur me këto çështje janë përpiluar disa raporte gjeologjike me të dhëna njoft të detajuara me fokus mineralizimin sulfur dhe janë shkruar artikuj shkencor në revista të ndryshme, duke prezantuar aspektet e veçanta të mineralizimit sulfur dhe të ndërtimit gjeologo - strukturor përmes brezin Qafë Mali - Spac në përgjithësi. Duke qënë se autorët e këtij artikulli kanë drejtuar për një kohë të gjatë punimet e kërkim - zbulimit në sektorin Qafë Bari - Munelle synojnë të prezantojnë disa fakte që avancojnë më tej shkallën e njohjes përmes mineralizimin sulfur të këtij sektori me vlera të rëndësishme teorike dhe praktike

NDËRTIMI GJELOGJIK I SEKTORIT

Në ndërtimin gjeologjik të sektorit te rajonit Munellë - Qafë Bari marrin pjesë lloje të ndryshme shkëmbore, përfaqësues të kores oqeanike (ekstruzeve të përbërjës bazike, mesatare dhe acide, kompleksi dajkor dhe intruzivet e përfaqësuar nga plagiogramite - diorite kuarcore), "Melanzhi Mirdita" i njohur si "pakoja argjilite me copra" dhe formimet konglobrekçore e karbonatike të barremian aptianit (fig. 1).

Studimet e fundit të realizuara në silicorët radiolaritikë që ndërthuren me ekstruzivet në sektorin e Munellë - Qafë Barit evidentojnë moshën bajosian i sipërm - kallovian i poshëm (Marcucci M etj 1994, Kodra A etj 1994, Kodra A etj 1995, Prela M. 2001) duke mbyllur një kapitull njoft të diskutueshëm ndërmjet studiuesve të mëparshëm që i kanë konsideruar këto vulkanite si të triasikut dhe më vonë për një kohë të gjatë si të J₂ - J₃. Mosha e "melanzhit Mirdita" e pa argumentuar faunistiksh , por mbi bazën e pozicionit gjeologjik të sajë jepet kallovian i sipërm - titonian i poshtëm (Kodra A, etj 1995), ndërkohë që për një kohë njoft të gjatë ky melanzh ishte trajtuar si i moshës jurasik - kretak i poshtëm. Formimet konglobrekçore dhe karbonatike i përkasin moshës bareman - aptian (Marku D. 2000). Duke qënë se këto të fundit vendosen pothuajse horizontalisht prekur pas aptianit nga ndonjë fazë orogenjike rudohosëse. Ndërkohë që në radiolaritet që ndërthuren me vulkanitet në sektorin e Qafë Barit - Munellë janë evidençuar edhe nga punimet e kërkim - zbulimit në venburimet Munellë, Qafë Bari etj (Balla A. 1979., Zoi N. 1984., Lleshi N, Leka Gj, Deda T. 1989).


Llojet intruzive të përfaqësura nga plagiogramitet dhe mikrodioritet kuarcore përhapjen kyesisht në pjesën perëdimore dhe veriperëndimore të rajonit. Nga të gjithë studiuesit e mëparshëm por edhe nga ana jone mardhëni e tyre me vulkanitet konsiderohen si intruzive, ndërkohë, këto mardhënie konsiderohen si tektonike sinformuese (Milushi I. 1992, 1995). Sekuencë vulkanogjene në sektorin tonë ndahet në 4 subsekuanca vulkanike (Bezhani V. etj 1995) që nga poshtë lart janë:

TIPE TË MINERALIZIMIT SULFUR NE SEKTORIN MUNELLE - QAFE BARI

Gjovalin LEKA, Tonin DEDA, Ndoc VUKZAJ

**HARTA GJEOLLOGJKE E RAJONIT
QAF BARI-MUNELLE-QAF LLSI
Shkalla 1:25000**

Sipos: Spira A.
(1962), Vranaj A.
etj. (1976)
Me plotesime nga
Gjovalin Leko (2001)



Subsekuencia bazaltike, bazalto-andezite, andezite dhe dacit - riolitike

Subsekuencia bazaltike

Subsekuencia bazaltike përfaqësohet nga facie të ndyshme si llavar jastekore, llava aglomeratike dhe më pak horizonte të veçanta tufesh. Kjo subsekuence është karakteristike për rajonin Tuç, Lak Roshi Qafë Bari, por fragmente të saj ndeshen edhe në Munellë. Në këtë subsekuencë përhapje të madhe kanë dajkat paralele me rënien lindore 60-80° deri vertikale të përbëra kryesisht nga diabaze, andezite, riocacite, mikrodiorite e plagioporfire. Nga studimi i kimizmit të tyre rezulton se në këto lloje shkëmbore TiO_2 varjon nga 0.29-0.88 % duke u futur në grupin e vullkaniteve me Ti të ulët që u korespondojnë formimeve të harkut ishullor. Marrëdhëniet me subsekuencën bazalto-andezite që vendoset mbi të janë graduale.

Subsekuencia bazalto-andezite

Përhapet gjërësisht në Tuç, Lak Roshi, Munellë, Qafë Bari, Spaç dhe përfaqësohet nga facie të llavave jastekore andezitike, aglomerate më rrallë xham vullkanik baziko - messatar.

Në këto lloje shkëmbore TiO_2 luhatet nga 0.4-0.87 % duke u futur në grupin e vullkaniteve me titan të ulët të tipit hark ishullor.

Subsekuencia andezitike

Këto vullkanite në rajonin tonë përhapen në Munellë dhe pjesërisht në Qafë Bari. Përfaqësohen nga andezite me teksturë kryesisht llava jastekore mikrokotizore, llava aglomeratike e më rrallë brekçie vullkanitesh. Edhe këtu marrëdhëniet me sekundaren riocacite janë graduale me kalime faciale në shtrirje dhe në rënje.

Subsekuencia dacit-riolitike

Këto vullkanite kanë përhapje të madhe në rajonin Qaf Bari-Munellë. Dacit-riolitet paraqiten kryesisht massive (Munellë, Gurit i Korbit, Qaf Bari), por vërehen edhe rryma aglomeratike e xhamore të përbërjës mesataro-acide.

Lidhur me këto massive dacit-riolitet kemi mendimin që mund të jenë derdhjet më të fundit të vullkanizmit jurasik si të tillë sistemi dajkor i tyre ndërpret gjithë prejën e vullkaniteve të përshtuara më sipër. Riocacetet e takuara në gurin e Korbit janë pothuaje të paminalizuara, nga pamja e jashtme janë massive shumë pak të ndryshuara dhe nuk ngasojnë me riocacetet e takuara në vendburimin e Munellës dhe të Gurthit të cilat janë të ndryshuara dhe të mineralizuara (fig. 2, shpjeguesi njëlljoj si në fig.3).

Këto vullkanite rezultojnë të llojeve toteite të mbingopura me përbajtje të ulët të TiO_2 , nga 0.31-0.64 % duke u futur kështu në grupin e vullkaniteve me titan të ulët të tipit hark ishullor.

Në këto vullkanite mesoacide në rajon lidhen mineralizimet massive të vendburimit Munellë dhe Qaf Bari.

Mineralizimet massive të këtyre vendburimeve shpesh shqërohen me silicore radiolaritike e tufë çka do të thotë se janë produkte të çfryerjes së lëndës xherore në fundit të detit.

Tipet e strukturorë të sektorit


Struktura Qaf Bari-Munellë përfaqëson një sinklinal të madh me shtrirje të përgjithësme meridionale me gjatësi rrëth 10 km dhe gjatësi 2 km (Kamberri R., Bardhoshi N. 1980., Lleshi N., Leka Gj., Deda T. 1989) Krahu perëndimor i këtij sinklinali ka rënien të fortë me kënd 60-65° (fig. 2, shpjeguesi njëlljoj si në fig.3). Ndërsa krahu lindor ka rënien të fortë me kënd 25-35°, ndërsa krahu lindor ka rënien të fortë me kënd 60-65° (fig. 2, shpjeguesi njëlljoj si në fig.3).

Në bërtamën e këtij sinklinali dalin formimet e përziera të melanxitit Mirdita (pakos argjilite me copa) të J_3-Cr . Sinklinali Qaf Bari-Munellë përbëhet nga struktura të rendeve më të ulta si sinklinali i Qaf Barit, antiklinali i Gurit të Korbit dhe sinklinali i Munellë-Kimzës. Këto struktura në përgjithësi janë të përmbyshura drejt perëndimit. Tërë këto struktura janë të komplikuara nga mbihipja gjatësore me drejtim V-J Qaf Bari-Gurth me amplitudë mbi 250-300 ml, me rënien lindore me kënd rrëth 20-50° që shënon mbihipjen e shkëmbinjve vullkanike mbi formimet argjilite me copa (fig. 5, shpjeguesi njëlljoj si në fig.1, 3).

Në shpimin C në Munellë kjo zonë tektonike është shoqëruar dhe me piritizim të lehtë. Nga përoi i Gurit të Korbit më në jug kjo tektonikë mbulohet nga një trashësi e konsiderueshme rrëth 200 m e trashë e pakos argjilite me copa, formacioni terrigen karbonatik i Kretakut dhe formimet e deluvioneve. Lidhja e saj me tektonikën mbihipëse që vjen nga Gurthi në sipërfaqe nuk vërehet në

Fig. 2.-Ne kette figure neqoqhen marrchedeñjet midis sussekhaq qal Bain Vener - Munele (shpiçeuq si ne fig. 3).

Fig. 2.-Ne kete figure megoheen marrchedhenijet midis subsekti



1. MINERALİZİMİ MASİV

Tipet e mineralizimit në sektorin Qafë Bari – Munellë.

kloritet, sericitet, kaolinitet, kuarcitet dhe epidoti janë mjaft të takuara në këtë sektor si në zonat e mineralizuara ashtu edhe në shkëmbinjtë rrethues, por asër trupave xehleror janë më të shprehura si në shtrirje ashtu edhe në rëniet.

Tipet e mineralizimit në sektorin Qafë Bari – Munellë.

Mineralizimi i sektorit Qafë Bari – Munellë reflekton tipare mjaft interesante përsa i takon mofologjisë së trupave, tipeve xehore, mardhënieve me shkëmbinjtë rrethues dhe përbërjes mineralogjike. Punimet e detajuara të kërkim – zbulimit dhe një kampionim i hollësishtë i zonave të mineralizuara në sektorin Qafë Bari - Munellë kanë mundësuar vëçimin e tre tipeve mineralizimi sulfur, ndarje e cila ka rëndësi teorike dhe praktike.

a- Mineralizimi masiv me natyrë polimetatalore

Zhvillohet në bazament të andeziteve dhe riocacideve, vendburimi Munelle (fig 3) dhe zhytet drejt lindjes me kënd të butë. Në pjesën perëndimore trupi mineral ka kontakte të prera me shkëmbinjtë rrethues dhe pothuajse nuk ka shenja të alterimit hidrotermal. Në tavan të trupit masiv janë takuar shpesh silicore të kuq me trashësi 15-20 cm që shërbejnë si nivel tepër gjatë punimeve të kërkim - zbulimit (shpimi 156, 159). Gjatësia në shtirje e këtij mineralizimi shkon 200 m, ndërsa në rënien rrëth 150 m (profili 1-1, fig - 3), ku ka edhe zhvillimin maksimal, dhe reduktohet deri në 30 m në drejtim të jugut profilit 4-4, shpimi 183. Trashësia e këtij tipi mineralizimi varjon nga 40 m shpimi 199 profili 1-1 deri në 2 m shpimi 152 profili 4 - 4. Në këtë tip mineralizimi sfaleriti dhe piriti predominojne ndaj kalkopiritit, tenantit, and galenit dhe bornitit. Teksturat kollomorfe janë të ruajtura mirë. Në tavatin e mineralizimit takohet tenantit ndërsa drejt skajeve duket një zvogëlim i sasisë së piritit dhe një rritje e kalkopiritit, sfaleritit, galenitit dhe tetraedritit. Në pjesën e sipërme gjendet një përqëndrim i sfaleritit dhe i galenitit, ndërsa kalkopiriti dhe tenantiti gjenden në të shumtën e rasteve në pjesën e poshtme të trupave.

Në këtë mineralizim, takohet shpesh barit automorf të zëvendësuar nga kuarci, piriti, kalkopiriti dhe tenantiti. Në trupat e mineralizuar mund të vërejmë një zonim të dobët mineralogjik të shprehur me një përqëndrim më të lartë të galenitit i sfaleritit në pjesën e sipërme dhe të kalkopiritit e tenantitit

Në këta xehororë përbajtja e elementeve kryesore dhe dytësore është si më poshtë:
 Zn = 3.6%, Cu = 4.12%, S = 39.4%, Au = 4.06gt, Co = 0.0042 %, Ag = 37 gt, Pb = 0.29 %,
 As = 0.41 %, Se = 0.00096%, Te = 0.00023%, Cd = 0.03 %.

Zhvillohet kryesisht në riocacite, vendburimi Munellë dhe në kontakt të riocacideve me bazaltet vendburimi Qafë Bari (fig. 4). Ky tip mineralizimi ndiqet në shtrirje rrëth 300m dhe rënie nga 200-400m. Brenda tipit masiv vërehet një heterogenitet i spikatur ku në disa raste predominojnë minerali i piritit kurse në raste të tjera minerali i kalkopiritit. Forma e trupave xehore është kryesisht thjerrzore me rënie të butë lindore 10° - 20° me trashësi nga 10-100m.

Elementet kryesore t  ketij tipi Jane S, Cu, Zn, Au, As. Squifit

28

sipërfaqe nga mbulesa e pakos argillite me copra, por mesa duket ajo kalon gati 600-700 m në lindje të kufirit të plagiogramiteve Mesul. Në veri ajo vazhdon në përendim të vendburimit Qaf Bari duke u përplasur me kufirin e plagiogramit-mikrodioritet kurse në jug në drejtim të Gurthit pothuajse shuhet.

Sektori i mineralizuar Qafë Bari – Munellë ka një gjatësi rrreth 4 km dhe gjerësi rrreth 350 m. Ndonesë venburimet Munellë. Qaffë Bari verior dhe objektet Qafë Bari Qëndror , Jugor dhe Guri i Korbit zënë sipërfaqe të kufizuara, zona e mineralizuar formon një brez pothuajse pa shkëputje me shtrirje veri – jug dhe rënje lindore me kënd $20 - 50^{\circ}$, por vërehen edhe rënje perëndimore si në Qafë Bari lindor, Guri i Korbit dhe pjesa e sipërme e vendburimit Munellë. Në këtë sektor janë zbuluar rezerva minerale të konsiderueshme, duke përbërë sot për sot sektorin me atraktiv të vendit tonë për biznesin vendas dhe të huaj që merret me industrinë e bakrit. Punimet e detajuara në sektor kanë mundësuar konturimin e shumë trupave industrial brenda zonës së fuqishme hidrotermalo – metasomatike me

PROFILII

MUNELLE

27

2




Fig.
5

2. MINERALİZİMİ ME PIKEZİMİ

Në zonat e fuqishme të përpunimit hidrotermal (zonat e mineralizuara) të sektorit Qafë Bari - Munellë janë vëçuar trupa industrial të emërtuar si tipi i mineralizimit me pikëzime. Trupa të tillë janë konturuar si në andezite (Munellë), (fig. 3), në riocacite (Munellë, Qafë Bari Jugor, Qafë Bari Oëndror dhe Qafë Bari Verior), (fig. 2, 3; 4). dhe bazalte - andezite në Qafë Bari Verior (fig. 4).

a.Xehroret e bakrit me pikzime
 Ne vendburimin Munellë këto mineralizime lidhen me andezitet dhe riodacitet dhe takohen nën dhei mbi mineralizimin e tipit masiv, në vendburimet Qafë Bari Jugor dhe Qafë Bari Qëndror janë të lidhura me radioacetet kurse në vendburimin Qafë Bari Verior këto mineralizime lidhen me bazalte - andezitet. Në përgjithësi formojnë trupa damarore – linxore dhe përbajtja e komponentëve të dobishëm ndryshon nga njëri vendburim në tjetrin si më poshtë. Në vendburimin Munellë Cu = 0.4 gr/ton ne Qafë Bari Verior Cu = 0.79%, Cc

b. Xeherorët e zinkut me pikëzime
Këta xeherorë lidhen me andezitet në vendburimin Munellë dhe me riadacetit në Qafë Bari Lindo dhe paq në Gurin e Korbit duke formuar trupa damarore deri pseudoshtresore të zhvilluar pathuajse.

Tömrtatja trupa kontore.
 Përbajtja mesatare e komponenteve të dobishëm është si më poshtë:
 Në venburimin Munellë: Zn = 2.8%, Cu = 0.2%, Co = 0.0021%, Au = 0.84 g/t, S = 2.87%, Ag = 27.53 g/t, në Qafë Bari Verior: Zn = 1.34, Cu = 0.12%, Co = 0,004%, S = 1.52%, ne Qafe Bari Jugor: Zn = 1.21%, Cu = 0.01%, Co = 0,003%.

c. Xeherorë baker-zink me pikëzime

Këta xeherorë përfshijnë një pjesë të vogël të rezervave të vendburimit Munellë, Qafë Barit Qëndror, Jugor dhe Guri i Korbit dhe përqëndrohen në andezitet. Në pjesën e sipërme afër sipërfaqësore këto trupa bëhen polimetalor, por natyra e tyre nuk është e qendrushme pasi zhvillohen ne forme poplore. Permbajtja e elementeve te ketij xeherori është si më poshtë:

Cu = 0.62 %, Zn = 1.51 %, Co = 0.028 %, S = 5.3 %, Au = 0.44 g/t, Ag = 26.53 g/t,
 Pb = 0.1 %, As = 0.2 %.

3. MINERALIZIMET SHTOKVERKORE

Ato lokalizohen në riadacite në venburimin Munellë dhe më pak në Qafë Bari dhe zhyten rrëth 30° drejt lindjes. Këto trupa me trashësi deri 50 m duke përfshirë edhe ndëthurjet sterile kanë një natyrë kryesisht piritore me pikëzime mesatare deri të dendura të piritit, si dhe damarëza kalkopiriti e më


S H P J E G U E S	
	Zone minerale
	Shpime te kryera
	Xeketroz bakti masiv
	Xeketroz bakti me pikezime
	Xeketroz zinku me pikezime
	Riodacite
	Bazaltandezite
	Dionite kuarcote
	Fig. 4.

The figure is a geological map titled "Preje teriore 1-1" with a scale of "Shkalla 1:5000". It features a coordinate system with horizontal X and vertical Y axes. The map is overlaid with several types of symbols: 'x' marks scattered across the upper portion; 'v' marks forming a large arc in the center; diamond shapes distributed throughout; and square symbols concentrated in a central, hatched area. Contour lines are drawn as dashed lines. A north arrow is located in the lower-left quadrant. A scale bar at the top left indicates distances of 600, 700, and 800 units.

Fig.

3. MINERALİZİMET SHTOKVERKORH

Ato lokalizohen në riadacite në venburimin Munellë dhe më pak në Qafë Bari dhe zhyten rreth 30° drejt lindjes. Këto trupa me trashësi deri 50 m duke përfshirë edhe ndëthurjet sterile kanë një natyrë kryesisht piroze me pikëzime mesatare deri të dendura të piritit, si dhe damarëza kalkopiriti e më



PROFILI STRUKTUROR MUNELLE-KIMEZ




Fig. 5. Tregohen narredherjet e pakos ardilice ne copa ne subsekuenca e vulkanike si ose roli i tektonikese mbllosore ne zhvendesjen e vulkaniteve dhe te mineralizuarit sulfur. (Shqejuesi si ne fig. 1, 3)

rrallë sfaleriti. Në thellësi trashësia dhe potenciali metalogenik i trupave të mineralizuara zgjohet. Shkalla e kristalizimit të këtij xehorori është më e përsosur se sa në mineralizimet me pikëzime. Vërehet gjithashtu mungesa e galenitit, boritit dhe markazitit si dhe prania e sfaleritit të pasur me indium dhe inkluzionet e kalkopirrit-bornitit në pirit. Kreth mineralizimeve shtokvëflore vërehet një zonë e alterimit hidrotermal që shtrihet deri në disa dhjetra metra në riocacite. Ky alterim shprehet me shfaqjen e një bashkëshoqerimi me sericit, pirit dhe kalcit që pseudomorfizon fenokristalet e plagioklasit. Këto shkëmbinj kanë tekstrurë mikrokristaline me aggregate sericiti, kuarci e kloriti. Pranë trupave të mineralizuara takohen zona të alteruara (kloritizuara e kaolinizuar). Kloriti bëhet me hekuror në afersi të trupave mineral dhe me përbërje magnezieale në periferi.

Përfundime
Mineralizimi sulfur piritoz me natyrë polimetalore bakër-zink-armbajtes i sektorit Munelle - Qafë Bari, bën pjesë në strukturën xehororë Qafë Bari - Munelle - Gurth Spac - Letiten, që ndodhen në pjesën qëndrore të brezit xehoror sulfuror Qafë Mali - Munelle - Spaç - Mashterore. Mineralizimet sulfure vulkanike e subvulkanike të këtij brezi xehoror lokalizohen në vulkanitet e ofioliteve lindore tip SSZ.

Vendburimet Munelle dhe Qafë Bari janë koncentruar në sekuencat vulkanike të niveleve të sipërme të prigesë së vulkaniteve të përfaqsuara nga lava jastekore dhe aglomeratike bazalto - andezite, andezito - bazalte dhe riocacite me xhamë vulkanike, duke qenë ndërpres deri në pajtushmeri me to. Mineralet kryesore janë pirit, kalkopirriti dhe sfaleriti, kurse më pak të përhapur janë mineralet falerce, galeniti, arsenopiriti, markaziti, magnetiti, hematiti, borniti, vurciti, enargiti, hessiti, gjeokroniti, burnoniti dhe minralejometalore kuarci, kloritet, sericit, ceolitet, e më rrallë karbonatet, epidoti, bariti e fluoriti që u përkasin facieve të ndryshimeve atësore. Përveç elementeve kryesore xehore me vlera industriale Cu, Zn, S, Au, Ag vërehen edhe përbajtje të ngitura edhe të Pb, Cd, As, Sb, Co, Mn, Se, Te, Basi elementë shoqërues dhe më rrallë edhe të Mo, Ga, Ge, Bi, In, Hg, Sn, Ti.

Mineralizimi sulfur pëfqësohet nga tipet xehororë masive koloidale dhe të brekçezuar në nivelet e sipërme te vendosur me kufi të prere dhe gradual, nga tipet damaro - pikëzimore dhe shtokverkore në nivelet më të thella me kufi gradual nëpërmjet metasomatiteve.

Në përgjithësi vërehet zonalitet i pjesëshëm dje jo shumë i qartë i mineralizimit, duke u vendosur kryesisht në pjesët e sipërme mineralizimet masive me kufi të prerë dje mineralizimet e zinkut, të plumb-zinkut, ndërsa ato shtokverkore vendosen me një rënie në thellësi, por vërehen edhe përqëndrime masive dhe mineralizime zinku edhe në nivelet e poshtme, si rezultat i mbivendosjes së mineralizimeve ndërprerëse të më vonëshme, pasi xehororët sulfurë janë formuar në disa stade mineralizimi.

Mineralizimi sulfur i këtij rajoni lidhet me veprimitarinë vulkanike e subvulkanike të J₂, të ofioliteve lindore SSZ, duke qenë mineralizime hidrotermale nënujore të lidhur me oxhaqet tymues të zinj të formimeve të suprasubduksionit.

Hidrotermat janë formuar si rezultat i komplekseve të qarkullimit sistemeve hidrotermale (modeli Franklin J. M., 1993), që jepin mineralizime masive nga oxhaqet e tymuesve të zinj në fund të detit dhe shtokverkore në thellësi, të shtjelluar edhe në studimet në vendin tonë për këto mineralizime (Gjata K. etj; Hoxha L.; Sinojmeri A., etj).

Origjina e hidrotermave është e dyfishtë, kryesisht nga veprimitaria magmatike e pjesërisht detare dhe mekanizmi i depozitimit kërkohet në vëçoritë tektono-strukturore. Hidrotermat kanë burim magmatik 95-98 %, pasi në xehororët e Munellës sipas të dhënavë izotopike të Sinojmerit A. (1990), dje në mineralizimet e tjera të këtij brezi xehoror, Kolendreu D.(1988, 1992, 1995) ka influencë të ujut detar S-34 ne masen 3.4-5%.

Mineralizimet e këtij sektori kanë përpiktivë të mëtejshme kërkimi për xehororë të bakrit, zinkut, piriteve dje te elementeve shoqërus me natyrë polimetalore

LITERATURA

- Balla A., Turku I.** *1979* Raport mbi rezultatet e punimeve gjeolgjike të kërmendoreve me gjendje 1.1.1978. Fondi Qëndrori i Gjeologjisë, Tiranë 1979
- Beccaluva L., Coltorti, M** *1994* Mid-Ocean ridge and supra-subduction affinities in the ophiolitic belts of Albania. Ophioliti 19 (1)
- Premti I., Saccani E., Siena F. Zeda O.** *1995* Studim i strukturave xehorore në rajonin e vendburimeve Palucë-Lak Roshi-Tuq-Qafë Bari-Munelle Gurth Spac - Mashterkore. Tiranë. Fq. 110. Fondi Franklin J. M., Lydon J. W.
- Brian J. Skinner** *1980* Gjenëza e vendburimeve xehorore (Ekonomic Geology) fq 244.
- Deda T., Sinojmeri A., Lleshi N., Leka Gj., Pjetri N.** *1995* Geological and mineralogical aspects of the Munella gold bearing sulphide deposit.
- Gjata K., Prenti I., Milushi I., Beccaluva, Coltroti M., E., Sienna F., Zeda O.** *1995* "Petrologjia e ofioliteve te Mirdites Qendrore dhe brezit lindor ofiolitik te Shqiperise" fq Saccani 264
- Gjata K., Milushi I., Deda T., Dacia A.** *1996* Geological constraints of two ophiolitic belts. Evolution and implications. Georisorse delle ofioliti Albaniane
- Tirane Hoxha L.** *1995* Sulphide mineralization of Albanian ophiolite volcanoes
- Hoxha L. Zagonjari B.** *1998* Zonation of sulphide mineralization in the Spaci-Gurth Spac area (SSZ ophiolites) Albania Alba-nia
- Hoxha L., Deda T., Prenga Li, Imami S., Gjeçi K** *1998* Përgjithësimi i pumimeve komplekse gjeologjike-geofizike-geokimike të kryera në rajonin Republikës së Kosovës
- Kamberaj R. Bardhoshi N.** *1980* Mali. Fq 77 Raport mbi rezultatet e punimeve të kërkimit zbulimi gjegjës
- Tiranë Kati P., Çarçani T., Deda T., Sinojmeri A., Pjetri N.** *1987* Kimizmi i xehorëve të Munellës fq...
- Kodra A., Bortolotti V., Makucci M., M Prela.** *1995* Stratigrafia dhe struktura e formacionit vulkanogen sedimentar dhe mbuleses se ofiliteve. Fondi Qëndrori i Gjeologjisë, Tiranë
- Lleshi N., Leka Gj., Deda T.** *1989* Raport mbi rezultatet e punimeve gjeologjike të kërmendoreve me gjendje 1.1.1989. Fondi Qëndrori i Gjeologjisë, Tiranë 1995
- Marcucci M. Prela M.** *1994* Pozicioni hapsinor dhe gjenetik i mineralizimeve furore ne rajonin Mushtë-Qafë Mali. Buletini i Radilarian assemblages in the Trissic and jurassic cherts of Albania. Ofioliti special issue on Albanian ophiolites: state of art and perspectives Ophioliti nr 19 (1).
- Marku D.** *2000* Mbi transgresionin e Baremanit në rajonin Munelle (zona Mirdita Qendrore) dhe ndryshimi i skemës stratigrafike. Fondi Qëndrori i Gjeologjisë, Tiranë
- Marku D. Milushi I.** *2001* Kretaku i Munelles
- Milushi I.** *1992* Synforming faults of Albanide ophiolites and their importance for correct structural interpretation.
- Milushi I., Bezhani V.** *1995* Mineralizimet e bakrit që lidhen me ophiolitet Shqipërisë
- Prela M.** *2001* Korelimi i sekuencave të radiolariteve të mbulesës parësore sedimentare të dy brezave ofilitike të Shqipërisë.
- Sinojmeri A.** *1990* Mineralogjia dhe paragjenezat e vendburimit vulkanogen me Cu, Zn, Pb, Au të Munellës, Mirdita Qendrore Shqipëri
- Shallo M.** *1966* Gjeologjia dhe mineralizimi sulfid i rajonit Munelle-Qafë Bari.
- Shallo M., Turku I** *1990* Ofiolitet e Shqipërisë (Disertacion)
- Zoi N., Kamberaj R.** *1984* Vulkanizmi ofiolitik dhe mineralizimet që lidhen me (Disertacion)
- Carosi R., Gardini S., Prela M** Raport mbi rezultatet e punimeve të kërkim-zbulimit me

SULPHIDE MINERALIZATION TYPES IN MUNELLE – QAF BARI SECTOR (CENTRAL MIRDITA – ALBANIA)

ABSTRACT

PARAMETRIZIMI GJEOSTATISTIK I REZERVAVE MINERARE

Ismail HOXHA

HYRJE

This contribution presents new data on types of copper – zinc sulphide mineralization based on recent mineralogical and isotopic studies.

Extrusive rocks ranging in composition from basic to acidic rocks, intrusive ones represented of plagiogranite – quartz diorite and sedimentary formation represented of “Mirdita melange” or “argillaceous pack with clasts” constitute the Munelle – Qaf Bari sector.

The host rocks of sulphide mineralization in Munelle – Qaf Bari sector belong to the uppermost part of SSZ ophiolite type of Mirdita ophiolitic complex.

Both geological structure and potential of copper sulphide mineralization were main reasons of abundant studies carried out in this to this sector.

The studies carried lead to the important conclusions concerning the morphology of ore bodies, mineral composition, types of mineralization, relation between ore and host rocks etc.

Based on these studies the following mineralization types are distinguished:

- a – Massive mineralizations of copper – pyrite
- b – Massive ore of polymetallic nature with high gold content
- c – Vein – disseminated ore stockwork nature of copper and zinc.
- Massive mineralization types are generally in conformity with volcanic sequences represented of basalte – andesite, andesite – rhyodacitic subsequences, which are the uppermost levels of volcanic rocks. Whereas vein and stockwork types are related with lower levels of volcanic rocks represented of basalte and basalte – andesite sequences.

In general, no regular zonality can be determined in this sector, but a weak zonality can be determined in different parts of ore deposits. In Munella and Qaf Bari deposits higher content of zinc, lead, gold, silver, antimony and other elements as Cd, Mo, Ge, Ga, Bi, In, Ba etc. are determined in upper parts and is generally related to massive ores showing colloidal textures. The reason of a weak zonality for Munella and Qaf Bari ore deposits and in general for all copper sulphide mineralizations of Central Mirdita is the overlap of several mineralization stages.

Based on the all studies carried out is confirmed that the sulphide mineralizations are related to volcanic activity of Middle Jurassic, part of Eastern SSZ ophiolite. The mineralizations are of sea floor type, where a important role seems to have played black smokers. Hydrotherms have had a double origine: magmatic and sea water. The magmatic role, as source of hydrotherms, is about 95 – 98%, since sulphur originated from sea water varies between 3.4 – 5 % (Kolndre D. 1988, 1992, 1995).

The studies on the types of mineralizations and their determination will further contribute not only for a more efficient prospecting but at the same for a more effective mining and processing.

i indeksi i një bloku cfarëdo;
v volumi i blokut;
g pesha specifike e mineralit;
t përbajtja mesatare e blokut *i*;
 c_e kostoja e shfrytëzimit për çdo njësi;
 c_i kostoja e përpunim-pasurimit për çdo njësi;
r rikuperimi i pasurimit;
 V^i vlera reale e blokut *i*;
 V_0 çmimi i metalit për çdo njësi.




Fig. 1 Paraqitja skematike e një vendburimi minerar te thellesise. Vlera reale e blokut elementar të përgjithshëm V_i jejet nga vlera e metalit të përbajtur në këtë blok minus koston e shfrytëzimit dhe të përpunim-pasurimit të tij:

$$V_i = V_0 \cdot v \cdot \gamma \cdot t_i \cdot \rho - v \cdot \gamma \cdot (C_e + C_f) \quad (1)$$

Duke pjestuar V_i me madhësinë $V_0 \gamma \rho$, e cila është një konstante e pavarur për çdo blok të veçantë, dhe duke grupuar të gjithë kostot në një term të vetem c_t do të kemi:

$$\frac{V_i}{V_0 \cdot v \cdot \gamma \cdot \rho} = V'_i = t_i - \frac{C_{tot}}{V_0 \cdot \rho} \quad (2)$$

Sic shihet madhësia V'_i vazhdon të shprehë, por në përpjestim me një konstante të caktuar $V_0 \gamma \rho$, vlerën e blokut i . Në qese madhesinë $C_{tot}/V_0 \rho$ mund ta konsiderojmë si një parameter të vetem λ , i cili varet nga kondicionet tekniko-ekonomike të projektit të shfrytëzimit minerar, atëherë do të kemi:

$$\frac{V_i}{V'_i} = t_i - \lambda \quad (3)$$

Në këtë kontekst, parametri λ është i krahasueshëm me përbajtje t_i , dhe përfaqëson numerikisht pikërisht vlerën e përbajtjes kufi, ose minimale, të shfrytëzimit që duhet të aplikohet për çdo blok elementar të shfrytëzimit.

Është e qartë, se parametri λ përfaqëson një parametr global për vendburimin i cili përdoret në fazën e projektit të shfrytëzimit ndërsa në rastin e shfrytëzimit minerar kur të dhënat janë të detajuara ky parametër llogaritet për çdo blok elementar të veçantë dhe seleksionimi aplikohet për çdo blok që përfaqëson një vlerë pozitive të V'_i ose që plotëson kushtin $t_i > \lambda i$.

Në fakt për një vlerë të fiksuar të λ bloqet B_λ të tillë që plotësojne kushtin e mëposhtëm:

$$\{B_i\} = Y \left\{ \begin{array}{l} t_i - \lambda i \\ \end{array} \geq 0 \right\} \quad (4)$$

Do të jenë ata bloqe që do të seleksionohen për qëllim shfrytëzimi. Një bashkësie të tillë bloqesh i korrespondon një sasi ose tonazh i caktuar T me një përbajtje mesatare t_m . Në këtë mënyrë, dukeq qartë që bashkësia e bloqeve të seleksionuara në këtë mënyrë është ajo optimale, në kuptimin që, përfshi njëtin tonazh, kjo është bashkësia e bloqeve që përban sasinë maksimale të metalit, prandiq vlerën më të madhe të përfitimit.

Duke konsideruar vlerat e tjera të mundshme të parametrit t do të merren bashkësi të tjera bloqesh, ku se cilës nga këto i korrespondon një çift i vlerave tonazh-përbajtje mesatare, të cilat të shprehura në mënyrë grafike përfaqësojnë pikërisht grafikun ose kurben tonazh-përbajtje [3]. Ky grafik shpreh sintetikisht në formë parametrike rezervat minerare të vendburimit (fig. 2). Duke njoftuar përbajtjen mesatare




Figura 2 Grafiku Tonazh-Pembajtje (majtas) dhe ai Tonazh-Metal (djathtas)

për çdo tonazh të caktuar mund të përcaktohet edhe sasia në metal Q që i korrespondon këtij seleksionimi tonazh-përbajtje. Sasia e metalit duke patur një vartesi pothuaj parabolike me tonazhin e rezervave shkon asimptotikisht drejt vlerës maksimale të metalit të përbajtur në vendburim kur tonazhi iritet në maksimum, d.m.th. megjithëse sasia e rezervave të nxjerra mund të vazhdojë të rritet, sasia e metalit të përfshuar mbetet konstante, për shkak se kjo rritje e tonazhit shoqërohet me uljen e përbajtjes mesatare në total.

Në interpretimin e mësipërm, është konsideruar seleksionim i lirë i bloqeve. Në praktikë një gjë e tillë është e kufizuar nga vartësia e kushteve gjemometrike të projektit të shfrytëzimit. Kështu vartësitet gjemometrike midis bloqeve të seleksionuar sipas metodës së shfrytëzimit masiv me nekate ose *sublevel stoping* Jane me të medha se sa ne rastin e metodes se shfrytëzimit selektiv me mbushje ose *cut and fill*. Në keto kushte shpesht ndodh që të seleksionohen edhe bloqe me përbajtje me të ulet dhe njekohesist te lilen ne vend pa u shfrytezuar disa te tjere me përbajtje me të latte (fig. 3).

Grafiku tonazh-përbajtje do te jetë ne kete rast me i ulet ne lidhje me ate te seleksionimit te lire, keshtu ne te verite te tonazh te barabarte do te merret një përbajtje mesatare me e ulet.

Faktori që shkakton një zvogëlim të shkallës së rikuperimit të vendburimit për shkak të vartësive mbi formën e bashkësisë së bloqeve të seleksionuara, zakonisht quhet *efekti i kufizimeve gjemometrike* të metodës së shfrytëzimit minerar. Ky efekt duhet të vlerësohet për zgjidhje teknike të ndryshme hipotetike për shfrytëzimin e një vendburimi. Kjo lejon edhe për optimizimin e zgjedhjes së metodës së shfrytëzimit duke bërë të mundur krahasimin e kostos më të lartë me rikuperimin më të madh në kuptimin e tonazhit dhe përbajtjes.

Metoda më praktike për realizimin e parametrizimit të një vendburimi duke mbajtur parasysh edhe vlersimin e efektit të kufizimeve gjemometrike është ajo e operimit mbi një model të përfshuar me anë të simulimit gjemostatistik kondicional të vendburimit [4]. Një model numerik i tillë është i nevojshëm edhe përfaktin se gjatë një studimi të fizibilitetit ekonomik, njoftja jo e detauar në këtë fazë e vendburimit nuk lejon një rikonstruksion të hollësishëm të tij duke u bazuar vetëm në vlerësimin paraprak të tij.


3. VENBURIMET SIPËRFAQSORE

Parametrizimi i vendburimeve sipërfaqsore paraqet disa elemente me kompleks në krahasim me rastin e shfrytëzimit nëntokso. Në fakt ndërsa në nëntokë shfrytëzimi është konceptuar kryesisht për shembjen dhe nxjerjen e pjesëve të vendburimit me përbajtje më të lartë se përbajtja kufi duke lënë në vend ato me përbajtje më të ulët. Ndërsa në shfrytëzimin sipërfaqsor normalisht largohet materiali steril përfshuar marjen e mineralit poshtë tij. Kështu përfshuar bloqun me numur 9 duhet që fillimi të zhvendosen bloqet me numur nga 1 në 9, n.q.s. skarpata e karrieres minerare do të jetë 45° (fig. 3). Ky hierarki midis bloqeve të seleksionimit përcakton kufizimet gjemometrike që duhet të merrin në konsideratë gjatë parametrizimit të rezervave.

	1	2	3	4	5		
	6	7	8				
			9				

Fig. 3 Paraqta skematike e bloqeve elementare të seleksionimit.

Për shkak të dimensioneve zakonisht të mëdha të trupave të mineralizuar, të cilet i nënshtrohen shfrytëzimit sipërfaqësor, njohja e vendburimit nuk është asnjëherë shumë e detajuar dhe për pasoje është i pamundur rikostruksioni e tij sipas njësive elementare të shfrytëzimit. Në këtë rast mund të operohet mbi një model të simular të vendburimit [5]. Kjo mund te arrihet nepermjet simulimit geostatistik te vendburimit me ane te se cilët arrihet të krijohet një model numerik i përfaqsuar nga ndarja e vendburimit në bloqe elementare me volum dhe përbajtje të përcaktuar. Nëpërmjet kësaj metode është e mundur të vlersohet për bloqet e mëdhenj përbajtja mesatare dhe sasia proporcionale, ose fraktioni i çdo bloku, që do ketë nevoje për përpunim shtesë ose për pasurim.

**Fig. 4** Paraqita skematike e një vendburimi sipërfaqësor

Duke ju referuar figurës 4, që skematizon hapsitën minerare të një vendburimi sipërfaqsor nëpërmjet bloqeve elementare dhe duke përdorur simbolet e mëposhtme do të kemi:

- i indeksi i një bloku elementar çfarðo
- v volumi i blokut
- γ pesha specifike e mineralit
- r_i fraksioni ose pjesa e shfrytëzueshme e blokut i
- t_i përbajtja mesatare e frakcionit të shfrytëzueshëm të blokut
- c_e kostoja për njësi e shfrytëzimit
- ρ rikuperimi i metalit në përpunim-pasurim
- V_i vlera reale e blokut
- V_0 çmimi i metalit për njësi

Vlera reale e blokut të përgjithshëm i jepet nga vlera e metalit të përbajtur në pjesën e shfrytëzueshme të blokut minus kostot e shfrytëzimit të blokut i dhe të përpunim-pasurimit të pjesës së shfrytëzueshës: r_i

$$V_i = V_0 \cdot v \cdot \gamma \cdot r_i \cdot t_i \cdot \rho - v \cdot \gamma \cdot r_i \cdot c_e \quad (5)$$

Duke pjestuar V_i me $V_0 v \rho$, e cila është një konstante në lidhje me blokun elementar, atëherë do të kemi që:

$$\frac{V_i}{V_0 \cdot v \cdot \gamma \cdot \rho} = V'_i = r_i t_i - \frac{c_e}{V_0 \cdot \rho} - \frac{r_i c_e}{V_0 \cdot \rho} \quad (6)$$

Ku V'_i gjithashu paraqet, me përijahtim të një konstanteje, vlerën e blokut i ndërsa faktorët $C_e / V_0 \rho$ dhe $C_t / V_0 \rho$ mund të shënohen përkatësisht me parametrat λ dhe θ . Kështu kemi:

$$V'_i = r_i(t_i - \theta) - \lambda \quad (7)$$


Pra vlera e blokut i mund të shprehet nëpërmjet dy parametrave që kanë së bashku kuptimin e një përbajtjeje dhe korrespondonjë ndërkaq me dy përbajtje kufi ku θ mund të konsiderohet si përbajtja kufi e krahasuar me koston e përpunim që duhet të aplikohet në njësinë elementare të shfrytëzimit për të dalluar destinacionin e saj (pasurim ose steril) ndërsa λ mund të konsiderohet si përbajtja kufi e krahasuar me koston e shfrytëzimit përvëç kostos së mundshme të përpunimit. Për një çift vlerash θ e λ të fiksuar, pjesa e vendburimit të shfrytëzueshëm është bashkësia e bloqeve $B \theta \lambda$ që respektojnë kufizimet gjemometrike të mësipërmë dhe maksimizon funksionin $\{B \theta \lambda\}$:

$$\{B \theta \lambda\} = \sum_{i \in B \theta \lambda} r_i(t_i - \theta) - \lambda \quad (8)$$

Kufizimet gjemometrike respektohen n.q.s për çdo blok që bën pjesë në bashkësinë $B \theta \lambda$ bëjnë pjesë në të njëjtën bashkësi edhe bloqet e nivelit më të sipërm që duhet të largohen për të lejuar shfrytëzimin e tij duke garantuar kështu pendencën e kërkuar të hapsirës minerare. Teknika e parametrizimit e ilustruar më sipër është veçanërisht e përshtatshme për karrierat sipërfaqsore ose open pit, të cilat përfaqsojnë minierat sipërfaqsore më të zakonshme. Ashtu si në rastin e shfrytëzimit nëntokso, kufizimet gjemometrike çonin në një ulje të rikuperimit të vendburimit në krahasim me një seleksionim të lirë ose pa kufizime.

VENBURIMET PRANË SIPËRFAQSORE

Këto vendburime mund të konsiderohen si një tipologji me vete për arsyen se përvec ngjashmërisë me vendburimet sipërfaqsore kanë edhe disa veçori. Zakonisht këto janë vendburime të tipit stratiform dhe në ndryshim nga vendburimet sipërfaqsore këto nuk dalin plotësishet direkt në sipërfaqe por janë të mbuluar nga një trashësi relativisht e vogël materiali steril i cili duhet të zhvendoset para se të shfrytëzohet minerali që ndodhet poshtë saj (fig. 5). Duke përdorur metodat gjemostatistike të simulimit kondicional mund të ndërtohet një model numerik i vendburimit i cili përcakton, në cdo pikë të planit që kemi në studim, trashësinë e sterilit mbi mineral, trashësinë e vetë mineralit dhe cilesine e mineralit, përbajtjen ose karakteristika të tjera të tij. Si dhe më sipër edhe për këtë tip vendburimi, duke u bazuar në modelimin numerik gjemostatistik, është i mundur parametrizimi i rezervave duke mbajtur parasysh njëkohësisht të gjitha karakteristikat e vendburimit të cilat në mënyra të ndryshme ndikojnë në shfrytëzimin e tij. Duke parametrizuar vendburimin bëhet e mundur të diferencojmë në planin horizontal pjesët e shfrytëzueshme me interes ekonomik.

**Fig. 5** Paraqita skematike e një vendburimi pranë sipërfaqsor

Duke ju referuar figurës 5, që skematizon hapsirën minerare të një vendburimi pranë sipërfaqesor nëpërmjet bloqeve elementare dhe duke përdorur simbolet e mëposhtme do të kemi:

i	indeksin e një bloku elementar cfaredo
A	sipërfaqja e blokut
γ_m	pësha specifike e mineralit
γ_c	trashesia e shtreses se blokut i
sm_i	trashesia e mbuleses se blokut
sc_i	frakzioni i dobishem i blokut i
r_i	permabajta mestare e frakzionit te dobishem
t_i	kostoja njesi e shfrytezimit dhe e perpunimit te mineralit
c_{tot}	vlera reale e blokut i
c_c	vlera njesi e metalit
V_i	
V_o	

Kështu vlera e blokut i jepet nga:

$$V_i = V_0 \cdot A \cdot \gamma_m \cdot sm \cdot r_i \cdot t_i - A \cdot \gamma_m \cdot sm \cdot c_{tot} - A \cdot \gamma_c \cdot sc_i \cdot c_c \quad (9)$$

Duke pjestuar të gjithë termat me $(V_0 \cdot A \cdot \gamma_m \cdot sm)$ dhe duke shënuar me R_i raportin midis tonazhit të materialit steril dhe tonazhit të vëtë mineralit $(\gamma_c \cdot sc_i) / (\gamma_m \cdot sm)$ dhe me parametrat θ dhe λ shënojmë respektivisht rapportet C_{tot}/V_o e C_c/V_o , do të kemi:

$$(10)$$

$V_i = r_i \cdot t_i - \theta - R_i \lambda$

Shënojmë bashkësinë e të gjithë bloqeve me B , atëherë për çdo çift vlerash θ, λ bashkësia e bloqeve me leverdi ekonomike do të jetë $B(\theta, \lambda)$ dhe llogaritet me anë të formules së më poshtme:

$$B_{\theta, \lambda} = \sum_{i \in B} (r_i \cdot t_i - \theta - R_i \lambda) \geq 0 \quad (11)$$

Gjithashtu kjo bashkësi bloqesh përbën edhe pjesën teknikisht të shfrytëzueshëm të vendburimit meqënëse në këtë rast nuk ka kufizime gjometrike që të ulin rezervat sepse është konsideruar që për të shfrytëzuar një pjesë të vendburimit është e nevojshme të largohet vetëm pjesa e mbulesës sterile sipër saj.

5. SHEMBULLA APLIKIMI

Si shembull të aplikimit të kësaj metodologji po paraqitim rastin e parametrizimit gjeostatistik të një vendburim pranë sipërfaqësor të tipit pseudoshtrresor i cili përfaqësohet nga një shtiri e konsiderueshme e mineralizimit fosfatik por me luhatje miaft të mëdha të trashësisë së mineralizimit (Tab. 1).

Tab. 1. Statistikat elementare sëpas punimeve të shpinit

Variblli	Mn	Max	Mësataja	Dev. standart	Koef. variac.(%)
Mbulesa (m)	0.20	6.00	2.13	3.26	153
Mineralizimi (m)	0.20	2.70	0.73	1.13	155
Frakzioni i dobishem	4.80	87.30	37.06	53.53	144
Pembajtja (%)	6.22	47.14	24.64	35.29	143

Mbulesa sterile ka gjithashtu një trashesi shumë te variushme te perfshire midis 0 dhe 4.0 m. Frakzioni granulometrik i cili perben mineralin e dobishem eshte ai i perfshire ne intervalin nga 0.7 mm deri ne 12 mm, ndersa cilesia e mineralit jepet nga permabajta ne % e $P_{2.5}$. Parametrizimi i rezervave eshte realizuar duke marre per baze rikonstruksionin numerik te vendburimit me ane te simulimit gjeostatistik kondicional te elementeve sipërfaqesore ne forme bloqesh me dimisione 12.5×12.5 m, duke u bazuar ne te dhenat e shipive.



Fig. 6 Seleksionimi sipas dy ciftave te vlerave (θ, λ) te permabajtjeve kufi.

Rezultatet e paraqitura në formë tabelore (Tab. 2) mund të paraqiten dhe në formë grafike (Fig. 6 dhe Fig. 7) ku mund të parashikohen lehtësishët në mënyrë të drejtëpërsëdrejtë treguesit endryshëm të mineralizimit në funksion të parametrave theta dhe lambda (θ, λ) të zgjedhur paraprakisht.

Me anë të kësaj metodologji është e mundur të rezultateve analitike ose grafike përcaktohen treguesit globalë të pritshtëm të mineralizimit në funksion të luhatjeve të tregut të shitjes së mineralit dhe të kostos së shfrytezimit minerar. Gjithashtu nëpërmjet paraqites grafiqe në planimetri është e mundur të përcaktohen lokalisht në mënyrë të detajuar zonat ose bloqet minerrare me leverdi ekonomike për shfrytezin.

Tab. 2 Rezultate e parametrizimit minerar në funksion te aplikimit te ciftave te ndryshme (θ, λ)

	Lambda	Theta	Volumi	Trashesia	Mbulesa	Frakzioni	Pembajtja
1	0.000	0.000	15310.00	2.170	0.770	0.330	23.450
2	0.000	1.000	13998.00	2.190	0.770	0.350	23.580
3	0.000	2.000	12522.00	2.210	0.770	0.380	23.830
4	0.000	3.000	11196.00	2.230	0.770	0.410	24.130
5	1.000	0.000	10244.00	1.890	0.820	0.400	24.250
6	1.000	1.000	9177.000	1.900	0.820	0.430	24.490
7	1.000	2.000	8183.000	1.890	0.800	0.460	24.750
8	1.000	3.000	7198.000	1.900	0.780	0.500	25.010
9	2.000	0.000	6801.000	1.570	0.850	0.460	24.880
10	2.000	1.000	5933.000	1.560	0.830	0.490	25.110
11	2.000	2.000	5146.000	1.550	0.800	0.530	25.330
12	2.000	3.000	4410.000	1.560	0.780	0.570	25.620
13	3.000	0.000	4424.000	1.270	0.850	0.510	25.320
14	3.000	1.000	3807.000	1.250	0.830	0.540	25.520
15	3.000	2.000	3229.000	1.250	0.800	0.580	25.900
16	3.000	3.000	2733.000	1.230	0.780	0.630	26.140

Me anë të parametrizimit të rezervave minerare bëhet i mundur vlerësimi i vendburimit për qëllim të sudimit të fizibilitetit i cili konsiston në vlerësimin e sasisë, ose tonazhit, dhe përbajtjes mesatare të mineralit që mund të shfrytëzohet nën kondicione të ndryshme. Meqënëse në këtë fazë të studimit të vendburimit, të dhënët e shpimeve në përgjithësi nuk janë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme që të lejojnë vlerësimin lokal të rezervave, atëherë është e rënjafshme të kryhet vetëm vlerësimi global i rezervave.

Në këtë kontekst, vlerësimi më anë të metodave gjeostatistike të interplimit, si ato të Krigingut, nuk është i përshtatshëm pasi informacioni është relativisht i pakët. Në këtë rast metoda më praktike është ajo e simulimit gjeostatistik kondicional. Me anë të kësaj procedurë realizohet rikonstruksioni numerik 3-D i vendburimit sipas modelit hapsinor të përbërë nga bloqe lementare me një volum të përcaktuar.

Mbi këtë model numerik aplikohet parametrizimi i rezervave duke mbajtur parasysh jo vetëm karakteristikat gjeologjike por edhe ato teknike sipas tipologjisë së vendburimit kryesisht në vartësi të metodës së shfrytëzimit nëntokësore ose sipërfaqësore. Praktikisht ndërtohen grafikët ose kurbat e tonazh-përbajtjes të cilat shprehin në mënyrë parametrike vartësinë nga karakteristikat jo vetëm gjeologjike por edhe tekniko-ekonomike të vendburimit.

Me anë të modelimit gjeostatistik bëhet e mundur të përcaktohet në mënyrë analitike, dhe jo për analogji sic ndodh shpesh, përbajtja kufi ose minimale e shfrytëzimit të rezervave minerare si përrastin e vlerësimit global në fazat paraprake të zbulimit të vendburimit ashtu dhe përrastin e vlerësimit lokal, ose për çdo njësi shfrytëzimi, të rezervave.


Teknika e mësippërme e parametrizimit nëpërmjet modelimit numerik me anë të simulimit gjeostatistik mund të përdoret mjaft mirë jo vetëm për vendburimet por edhe për parametrizimin e volumit të terrenit që duhet rehabilituar ose bonifikuar në rastin e ndotjeve të terrenit nga kontaminues të natyrave të ndryshme. Në këtë rast rolin e përbajtjes kufi të mineralit e luan vlera maksimale e lejuar e kontaminimit të terrenit.

LITERATURA

- Matheron G. 1975 *Le paramétrage technique des réserves. Note Geostatistique n° 134*, 1975, p. 49.
- Deraisme J., et al. 1984 *Geostatistical orebody model computer optimisation of profits from different underground mining methods*. In 19th International Symposium APCOM, London 1984.
- Coléou T. 1988 *Le paramétrage technique des réserves. Sciences de la Terre, Serie Inf. Geol. n° 28*, Juin 1988, p. 115-128.
- Journel A, Huijbregts Ch. 1978 *Mining Geostatistics*. Academic Press.
- Chiles J-P., Delfiner P. 1999 *Geostatistics: modeling spatial uncertainty*. John Wiley & Sons, 700 pp.
- Raspa G, Bruno R., Lopes Da Silva E. 1995. *Parametrization of recoverable reserves of a stratified deposit*. In *Geologia Angolana*, Journal of Geosciences, p. 18-27.

Fig. 7 Paraqitura 3D e variacioni të treguesve mineralizimit në funksion të parametrit Lambda (λ) dhe Theta (θ)

$$(\theta = C_{tot}/V_0; \lambda = C_c/V_0)$$



ABSTRACT

PARAMETRIZATION OF RECOVERABLE RESERVES

1. HYRJE

This article describes a procedure for evaluating the recoverables reserves of different deposit types. Their evaluating for feasibility study consists in estimating the tonnages and grades of ore that can be extracted under different conditions. At such stage of feasibility study, the location of mining units are not relevant because the drilling data generally available are not sufficiently detailed to permit their estimation. Since the aim is not to obtain an evaluation of a single mining unit but a global evaluation of the deposit as a whole or even by large panels, the direct estimation, such as methods of Kriging, are not suitable while the use of simulation techniques for reserves estimation appears to be appropriate. Under such conditions, the most practical method is to build a block model for the concerned deposit through the conditional geostatistical simulation of the elementary mining units and then to apply to that model a suitable selection process for the envisaged mining method. of the deposit and calculating the recoverable reserves by applying to the geostatistical simulation model a selection process based on the technical and economic parameters, such as cut-off grade, selectivity of mining method.

KARAKTERISTIKAT SIZMOTEKTONIKE TË KOSOVËS

Zenun ELEZAJ

Kosova shtrihet në pjesën qëndrore të Ballkanit dhe mbulon një sipërfaqe prej 10.887 km^2 . Territori i saj karakterizohet me lartësi mesatare mbidetare mbi 800 m e me ndryshme të mëdha morfolologjike. Këto ndryshime të mëdha morfolologjike, rrijedhin si pasojë e ndërtimit gjeologjik të komplikuar, veprimitarisë së shprehur të lëvizjeve tektonike dhe proceseve eroduese. Territori i Kosovës karakterizohet me një ndërtim të komplikuar gjeologo-tektonik, e shprehur me prezencën e shkëmbinjve me përbërje e moshë gjeologjike të ndryshme, si dhe me prezencën e strukturave të ndryshme tektonike, shkëputëse e rrudhosëse.

Territori i Kosovës nga aspekti hapsinor i përket dy njësive të mëdha gjeotektonike: Dinarideve (pjesa më e madhe) dhe Masës Dardane (Masa Serbo-Kosovare-Maqedone) [3]. Meqë Kosova karakterizohet me ndërtim të komplikuar gjeologjik dhe tektonik, edhe në aspektin szizmologjik, përfaqëson një terren miaft aktiv, i cili mund të goditet nga tërmete katastrofike me karakter autohton. Të dhënat për tërmetet, që datojnë nga kohërat e lashta, tregojnë se Kosova është goditur nga tërmete katastrofike, ndër të cilët përmendim këta tërmete: viti 1456 me intensitet IX ballë MSK-64, që goditi rëndë rrethin e Prizrenit; viti 1662 me intensitet VIII ballë MSK-64, i cili goditi rrëthin e Pejës; viti 1921 me intensitet epikëndror IX ballë MSK-64, që goditi fort rajonin Ferizaj-Vitti; dhe viti 1980 me intensitet VIII ballë MSK-64, i cili preku fort rajonin e Kopaunikut. Në Kosovë përvëq tërmeteve me vatra autockone, brenda territorit të saj, ajo është tronditur bille edhe fort nga tërmetet të gjeneruar nga jashtë territorit administrativ të saj, nga Maqedonia, Shqipëria, Serbia e Mali i Zi [6,7].

Këto dy dukuri, pra sizmicitë lokal dhe sizmicitë që shkaktohet nga tërmetet e largëta, e përcaktojnë territorin e Kosovës të klasifikohet në radhën e vendeve me aktivitet szizmik të lartë. Kjo situatë szizmike mjaff e lartë kushtëzon nevojën e kryerjes në të ardhmen të studimeve të detajuara kompleks sismologjike e szizmotektonike, në mënyrë që të fitohet një përfshyrim më i plotë lidhur me vlerësimin e rrezikshmërisë szizmike (tërmetore) të Kosovës.

2. STRUKTURA NEOTEKTONIKE E KOSOVËS

Neotektonika, si dihet, studion strukturat më të reja, pasqyrimin e tyre në relievin e sipërfaqes së tokës dhe tipet e ndryshme të lëvizjeve tektonike e proceset dinamike që i kushtëzojnë ato. Ajo studion si lëvizjet e reja tektonike ashtu edhe lëvizjet e sotme, që kanë prekur e prekin koren e Tokës [1,2].

Aspektet e hulumtimeve neotektonike për territorin e Kosovës, janë të lidhura ngushtë me studimet e njësive morfostrukturale të lindura nga lëvizjet tektonike, në kohrat më të reja gjeologjike, gjatë neogjenit dhe kuaternarit, në etapën neotektonike. Studimi i aktivitetit neotektonik të Kosovës, është i lidhur ngushtë me njohjen e gjeologjisë së hershme historike, për ti njojur lidhjet në mes të lëvizjeve tektonike të hershme me lëvizjet neotektonike.

Gjatë etapës neotektonike, territori i Kosovës është përfishirë nga proceset tektonike, të cilat kanë kushtëzuar formimin e njësive të reja morfostrukturale, si struktura me tendencë mbizoteruese në ngritje, në zhytje dhe me aktivitet vulkanik [4,5] (see Fig. 1).

a) Trevat e Kosovës me tendencë mbizoteruese në ngritje
Trevat me tendencë mbizoteruese në ngritje, në hartën szizmotektonike duhet të kufizohen me izolinja, të cilat tregonin vlerën reale të ngritjes vertikale gjatë neogjenit dhe kuaternarit. Në mënyrë të veçantë në hartë duhet të veçohen pjesët e ndërtuara me vulkanite të neogjenit dhe kuaternarit, ku gjatë ditëve tona, aktivitetet postvulkanike manifestohen me dukurinë e ujраве termominrale, e cila

dëshmon për egzistencën e fushës së shprehur gjetërmale. Trevat me tendencë mbizotëruese në ngritje, janë ta ndara në bloqe të vecanta, të emëruara me numra arab prej 1 deri 13 [6,7]:

1. Bloku i Dukagjinit,
2. Bloku i Bjeshkëve të Pashtrikut dhe Devës,
3. Bloku i Sharrit,
4. Bloku i Mushtishtit,
5. Bloku i Bjeshtës dhe Koprivnikut,
6. Bloku i Malit të Zi te Shkupit,
7. Bloku i Kaçanikut,
8. Bloku në mes Basenit të Drenicës, Kosovës dhe Maleve të Çičavicës,
9. Bloku në mes Mitrovicës, Moknës dhe Basenit të Drenicës,
10. Bloku në mes të Moravës së Binçes dhe Basenit të Podujevës,
11. Bazeni i Albankut (Kopaunikut),
12. Bloku i Krivarekës,
13. Bloku i masivit vulkanogjen të Lecës.

b) Trevat e Kosovës me tendencë mbizotëruese në zhytje
Këto janë depresionet e mëdha të njohura të neogjenit, në të cilat janë depozituar sasi të mëdha të materialit molasik, ku janë konstatuar rezerva të mëdha të qomyrit. Janë të njohura këto basene [6,7]:

1. Baseni i Dukagjinit:
 - pjesa e Pejës
 - pjesa e Gjakovës,
 - pjesa e Prizrenit dhe
 - pjesa e Bellanicës
2. Baseni i Drenicës,
3. Baseni i Kosovës:
 - pjesa Podujevës
 - pjesa e Moravës së Binçës,
4. Baseni i Krivarekës.

c) Aspekte të evolucionit neotektonik të Kosovës
Sipas të dhënave të parashtruara më lart, evolucioni neotektonik i Kosovës mund të përblidhet si vijon:

1. Gjatë etapës neotektonike në Kosovë janë formuar njësi morfostrukturore, të shprehura me massive malore, si treva me tendencë mbizotëruese në ngritje, dhe depresione, si treva me tendencë mbizotëruese në zhytje. Këto morfostruktura janë formuar si rezultat i lëvizjeve tektonike diferencale kryesisht gjatë pliocen-kuaternarit, në këtë etapë të orogenezës Alpike. Kufinjtë natyral të njësive morfostrukturore janë shprehur me shkëputje normale [2]. Etapa neotektonike ka qenë e shoqëruar edhe me aktivitet vulkanik në zonën e Vardarit dhe në pjesët perëndimore të Mases Dardane. Kjo nënkupton se magmatizmi është mjaft aktiv në pjesët e thella të kores tokësore. Aktiviteti vulkanik vazhdon edhe gjatë kuaternarit.
2. Aktiviteti neotektonik manifestohet në morfollojinë e shkëputjeve normale dhe në sizmicitin e gjeneruar prej tyre.

3. SIZMICITETI I TERRITORIT TË KOSOVËS

Duke patur parasysh se në territorin e Kosovës janë realizuar hulumtime jo të mjaftueshme sizmike, detyrë me rëndësi është që të bëhet përpunimi detajuar i të dhënave dhe publikimeve mbi sizmicitin e këtij rajoni. E veçantë e angazhimit tim do të jetë marja parasysh e të dhënave për tërmetet, duke filluar nga ata me intensitet V ballë MKS-64 e lartë. Katalogu për tërmetet që e kanë goditur këtë rajon dhe hartat e izoseisteve përfaqësojnë të dhënat



Fig. nr 1

themelore, me të cilat do të shërbohen për avancimin e përpjekjeve të mia mbi sizmicitetin e territorit të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në sa më lartë u tha, rezulton se studimet sizmike për territorin e Kosovës nuk janë realizuar në nivel të duhur. Shkalla e studimeve sizmike, asnjëherë nuk do të jetë e nivelit të duhur, nga se duhet patur parasysh se çdo tërmet i ri, i cili do të godasë territorin, do të ofrojë të dhëna të reja për plotësimin e atyre egzistuese.

Sipas të dhënave të deritanishme sizmike, në truallin e Kosovës shqulen mirë tri zona të fuqishme sizmogjene [6,7]:

1. Zona Dinarike, e cila përfshin pjesën perëndimore të Kosovës,
2. Zona Dardane, e cila përfshin pjesën lindore të Kosovës,
3. Zona e Sharrit, që mbulon pjesën jugore të Kosovës.

Në secilën prej këtyre zonave sizmogjene, egzistojnë rajone epiqendrore të cilat karakterizohen me lidhshmëri gjenetike. Autokontonia e tërmeteve dhe lidhshmëria gjenetike në mes të rajoneve të ndryshme epiqendrore, është një problem i cili kërkon hulumtime të detajuara gjeologjike, sizmologjike dhe geofizike.

Për studimin e aktivitetit sizmik të territorit të Kosovës kam grumbulluar shumë të dhënave sizmike, të cilat do ti paraqesë më poshtë.

3.1. KATALOGU I TERMETEVE DERI NE VITIN 1985

Duke u mbështetur në të dhënat egzistuese, po japim të dhënat për tërmetet të përbledhura në tabelën nr. 1 [6,7,8,9,10,11].

Si shifet nga të dhënat që i përban katalogu, prej 115 tërmeteve që përfshihen në të, vetëm dy i takojnë periudhës para vitit 1900, ndërsa të tjerat i takojnë intervalit kohor 1901-1985. Për tërmetet para vitit 1900 informacionet janë të varfëra. Prej tabelës së mësipërme shihet qartë, se në Kosovë nuk kanë qenë të rralla rastet kur ajo ka qenë e goditur nga tërmetet e fuqishme, VII-IX ballë MSK-64. Katalogu i tërmeteve tëndodhura përfaqëson të dhënat themelore për hulumtimet e mëtejme sizmike për rajonin Gjegjës. Për këtë arsyje katalogu i tërmeteve, është i përpiluar me saktësi, ku para çdo tërmetit janë bartur parametrat kryesor: data, koha e ndodhjes, koordinatat e epiqendrës, thellësia e hipocentër (km), magnituda, shkalla e intensitetit në ballë MSK-64 dhe vendi më i afërt ku ndodhet epiqendra.

3.2. HARTA E IZOSEISTEVE TË TERMETEVE PËR PERIUDHËN DERI NË VITIN 1985

Hartat e izoseisteve, së bashku me katalogjet e tërmeteve përfaqsojnë të dhënat themelore faktike në bazë të së cilave përcaktohet sizmiciteti i rajonit të studuar.

Izoseistet porfaqsojnë linja të lakuara dhe të mbyllura, të cilat rrethojnë territorin që karakterizon intensiteti i njëjtë, në sipërfaqe të Tokës. Karakteri i shpërndarjes, forma dhe madhja e izoseisteve tregojnë për karakteristikat e shpërndarjes së intensitetit të tërmetit në zonën e goditur prej tij, e lidhur ngushtë me kushtet gjeologjike të terenit. Ato tregojnë edhe për karakterin e dendësisë së izoseisteve të tërmetit në raport me distancën prej epiqendrës. Këto janë të dhëna me rëndësi, të cilat duhet të studiohen për secilin tërmet.

Numri i hartave të izoseisteve të analizara, në krahasim me rajonin epiqendror në të cilin kanë ndodhur tërmetet, jepen në tabelën që vijnë [6,7]:

Për përpunimin e hartave të izoseisteve dhe përcaktimin e parametrave kryesore të tërmeteve, përfaqojmë këto formula, të cilat përfaqsojnë lidhjet korelativë të mes të parametrave kryesore të

Nr	Data	Koha Ora min.	Kordinatat		Thellësia	Magnituda	Intensiteti
			V	L			
1	16 Qeshor 1456	0	0	42.2	20.7	0	6.6
2	11 Nëntor 1662	0	0	42.7	20.3	0	6.0
3	05 Maj 1907	17	01	42.5	21.9	8	5.1
4	05 Maj 1907	17	48	42.5	21.8	8	4.2
5	12 Gusht 1907	13	15	42.5	21.8	0	4.1
6	13 Gusht 1907	02	20	42.5	21.8	0	4.1
7	19 Dhjetor 1907	04	29	42.1	21.3	6	4.5
8	30 Qershor 1921	09	37	42.2	21.1	0	3.8
9	10 Gusht 1921	14	10	42.3	21.3	20	6.2
10	10 Gusht 1921	14	20	42.3	21.3	20	4.0
11	10 Gusht 1921	14	40	42.3	21.3	25	4.8
12	11 Gusht 1921	02	27	42.3	21.3	20	4.0
13	11 Gusht 1921	05	30	42.3	21.3	20	4.0
14	11 Gusht 1921	09	31	42.3	21.3	20	4.0
15	11 Gusht 1921	14	35	42.3	21.3	20	4.0
16	13 Gusht 1921	21	06	42.3	21.3	20	4.0
17	15 Gusht 1921	08	23	42.3	21.3	15	5.4
18	20 Gusht 1921	19	21	42.3	21.4	4	5.1
19	24 Gusht 1921	07	55	42.3	21.3	20	4.0
20	25 Gusht 1921	11	00	42.3	21.2	0	3.8
21	28 Gusht 1921	18	30	42.3	21.4	0	3.8
22	29 Gusht 1921	01	15	42.3	21.4	20	4.0
23	30 Gusht 1921	09	37	42.3	21.3	10	4.2
24	02 Shtator 1921	09	41	42.4	21.5	10	4.9
25	02 Shtator 1921	11	25	42.3	21.3	20	4.0
26	09 Shtator 1921	09	17	42.3	21.3	25	4.8
27	10 Shtator 1921	03	20	42.1	21.4	5	4.6
28	11 Shtator 1921	15	47	42.1	21.5	5	4.6
29	21 Shtator 1921	09	38	42.3	21.3	8	5.0
30	24 Shtator 1921	09	05	42.0	20.7	0	3.8
31	30 Shtator 1921	15	55	42.0	20.7	0	3.8
32	03 Tetor 1921	12	30	42.3	21.3	7	5.6
33	05 Tetor 1921	12	26	42.3	21.3	5	4.6
34	11 Tetor 1921	22	04	42.4	21.3	0	3.8
35	14 Tetor 1921	17	10	42.4	21.3	15	4.2
36	07 Nëntor 1921	17	19	42.3	21.4	0	3.8
37	07 Nëntor 1921	22	23	42.1	21.4	8	4.4
38	08 Nentor 1921	02	57	42.0	21.4	9	5.2
39	17 Dhjetor 1921	09	54	42.3	21.4	11	4.0
40	07 Shkurt 1922	12	55	42.3	21.4	0	4.1
41	11 Shkurt 1922	16	50	42.3	21.4	0	3.8

42	24 Shkurt 1922	13	15	42.3	21.3	12	5.0	7
43	24 Shkurt 1922	13	21	42.4	21.1	20	4.6	6
44	27 Shkurt 1922	14	02	42.2	21.3	0	3.8	5
45	19 Mars 1922	06	47	42.3	21.4	0	3.8	5
46	14 Gusht 1922	04	10	42.3	21.5	0	3.8	5
47	03 Shtator 1922	03	11	42.4	20.4	25	5.3	7
48	06 Shkurt 1923	14	10	42.3	21.4	0	3.8	5
49	23 Prill 1923	23	00	42.3	21.3	25	4.2	5
50	17 Maj 1923	17	20	42.3	21.5	0	3.8	5
51	17 Gusht 1923	01	03	42.6	21.1	5	4.0	6
52	17 Gushit 1923	01	30	42.7	21.3	0	3.8	5
53	21 Shtator 1923	23	59	42.2	21.4	6	3.9	6
54	26 Shtator 1923	22	58	42.0	20.8	0	3.8	5
55	08 Shkurt 1924	02	59	42.3	21.4	0	3.8	5
56	08 Shkurt 1924	02	34	42.3	21.4	0	3.8	5
57	25 Prill 1924	10	53	42.3	21.3	14	4.3	6
58	16 Maj 1924	18	23	42.3	21.3	23	4.7	5
59	10 Gusht 1924	20	02	42.3	21.3	20	4.0	5
60	28 Qershor 1925	20	45	42.2	21.4	0	3.8	5
61	29 Qershor 1925	20	45	42.3	21.3	20	4.0	5
62	03 Qershor 1925	06	17	42.3	21.3	15	4.2	5
63	22 Tetor 1926	23	53	42.1	20.6	22	4.9	6
64	23 Tetor 1926	10	54	42.3	20.7	0	3.8	5
65	25 Tetor 1926	16	21	42.3	21.3	18	3.9	5
66	17 Dhjetor 1926	06	41	42.4	20.6	6	4.2	6
67	27 Shkurt 1927	20	20	42.3	20.6	0	3.8	5
68	20 Maj 1927	17	00	42.9	20.8	0	3.8	5
69	07 Gusht 1927	05	25	42.4	20.8	20	4.4	5
70	17 Shkurt 1928	01	20	42.4	21.4	8	3.8	5
71	10 Mars 1928	12	17	42.3	21.3	12	4.0	6
72	17 Mars 1928	19	40	42.3	20.7	12	4.0	6
73	17 Mars 1928	20	03	42.3	20.7	12	4.0	6
74	08 Mars 1929	13	55	42.8	20.8	0	3.8	5
75	02 Shtator 1931	01	30	42.9	20.9	0	3.8	5
76	26 Nentor 1931	21	26	42.8	20.7	7	4.2	6
77	27 Nentor 1931	01	29	43.0	20.8	10	4.0	5
78	28 Nentor 1931	11	57	42.9	20.8	20	4.3	5
79	28 Nentor 1931	12	58	43.0	20.9	12	4.9	6
80	19 Prill 1932	02	03	42.8	20.7	22	4.2	5
81	19 Prill 1932	12	03	42.8	20.7	14	4.6	6
82	04 Maj 1932	14	40	42.8	20.7	0	3.8	5
83	27 Shtator 1932	15	59	42.4	20.7	26	4.5	5
84	27 Shtator 1932	17	01	42.4	20.7	0	3.8	5
85	18 Shkurt 1933	11	10	42.1	20.7	0	3.8	5

Edhe pse numri i hartave të izoseisteve është relativisht i madh, kjo prapsepaprë nuk është e mjaftueshme, nga që numri më i madh i këtyre hartave i dedikohet tërmeteve të rajonit Ferizaj-Viti. Këto hara të izoseisteve në përqindje më të madhe mbështeten në tërmetin katastrofik që ka ndodhur në vitin 1921 dhe në pasgoditjet kryesore të tij. Në këto hara është dhënë edhe një pjesë e hartës së izoseisteve për tërmetin e Albanikut të datës 18.05.1980, e cila pasqyron pjesën e Kosovës. Në qoftë se e analizojmë formën e këtyre hartave të izoseisteve, shihet qartë se ajo kryesisht ndjek konturet gjeologjike të rajoneve epikjëndore. Kështu për shembull, shtirja e izoseisteve për tërmetet e rajonit Ferizaj-Viti ka drejtim jugperëndim-verilindje, në pajtueshmëri me konfiguracionin e depresionit të Ferizajt.

Në sismologji janë të njohtur aspektet se pleistoseistet përfaqsojnë projeksionin e vatrës së tërmetit në sipërfaqe të Tokës. Kështu që dimensionet e pleistoseisteve mund të merren edhe si masë për madhësinë

e vatrës së tërmetit. Këto karakteristika të tyre ofrojnë mundësi për hulumtime të mëtejme nga aspekti i madhësisë së vatrave të tërmeteve, dhe energjisë së tyre dhe në fund edhe nga pasojat që do të lindin nga këto vatra të tërmeteve. Këtu do të cekim vetëm atë se parametri i izoseisteve merret parasysh vetëm në përcaktimin e burimeve sismogjene për territorin e Kosovës.

tërmeteve:

Numri i tërmeteve	V	VI	VII	VIII	IX
64	30	11	8	2	

$$\begin{aligned} I_0 &= 1.8 M - 4.2 \log h + 3.3 \\ I_0 - I_1 &= 4.2 \log D^2 + h^2/h \end{aligned}$$

Ku jame: I_0 - intensiteti i tërmeteve në epiqendrë, i shprehur në shkallën MSK-64

M - magnituda;

I_1 - intensiteti i tërmetit në distancën D , (km) prej epiqendrës;

h - thellësia e hipogondrës (km);

Në bazë të analizës dhe interpretimit të dhënave sizmologjike, të katalogjeve të tërmeteve dhe hartave të izoseisteve, të cilat kanë një rëndësi të madhe për studimet sizmike në territorin e Kosovës, janë siguruar të dhënat kryesore sizmike.

Rajoni epiqendror	Ferizaji, Vitia, Gjilani	Prizreni, Rahoveci	Gjakova	Ujëmira
Nr. i hartave të Izoseisteve	31	4	1	1

3.3. HARTA E INTENSITETEVE MAKSIMALE PËR TERRITORIN E KOSOVËS, PERIUDHA 1900-1985

Kjo hartë përfaqson shpërndarjen e intensiteteve maksimale të vrojtuar, sipas shkallës MSK-64, në territorin e Kosovës në intervalin kohor 1900-1985. Kjo hartë është e ndërtuar nga përgjithsimi i gjitha hartave të izoseisteve për tërmetet që kanë goditur Kosovën për periudhën 1900-1985 (Fig. 2).


Në qoftë se e analizojmë këtë hartë, shifet qartë se i tërë territori i Kosovës është prekur nga godijet sizmike. Vetëm një pjesë e territorit të Kosovës, pjesa përfëndimore e saj karakterizohet me shkallë të ulët të intensitetit (VI balle MSK-64), ndërsa pjesa më e madhe e territorit të saj karakterizohet me shkallë të lartë të intensitetit sizmik: VII, VIII, dhe IX balle MSK-64. Me shkallën IX ballë të intensitetit sizmik karakterizohet territori i Ferizajit.

Në këtë hartë (Fig. 2), siç shihet nuk janë marrë parasysh tërmetet me shkallë të intensitetit IX ballë MSK-64 të periudhës deri në 1900, sepse për ato tërmete nuk egzistojnë hartat e izoseisteve.


3.4. HARTA E EPIQENDRAVE TË TËRMETEVE NË TERRITORIN E KOSOVËS, PERIUDHA 1900-1985

Harta e epiqendrave të tërmeteve të Kosovës kallëzohet në Fig. 3, e përpiluar duke u mbështetur në katalogun e tërmeteve për territorin e Kosovës që përfshin edhe të dhënat për tërmetet e dobëta,

Harta e zones se tërmeteve me intensitet maksimal (MCS) për Kosovën 1900-1985



Harta e epiqendrave për Kosovën, e punuar ne baze te dheneve te Balkan-Projektit i 1976
1900-1985 M>3.8



duke filluar prej atyre me magnitudë 3.8 dhe më të mëdha, respektivisht prej intensitetit V ballë e lart. Si shihet nga legjenda e hartës, epiqendrat janë evidentuar me rrathë me rrezen përkatëse sipas magnitudës së tërmetit. Thellësia e hipocentërës së tërmeteve në legjendë është e shprehur në km. Kjo hartë tregon zonat në Kosovë që janë goditur nga tërmete autoktone. Këto janë rezultatet më të rëndësishme dhe faktorë të pazëvëndueshëm, të cilët tregojnë se pjesa më e madhe e territorit të Kosovës, saktësish pjesa më e madhe e qyteteve dhe vendbanimeve të tjera, janë të vendosura mbi vatrat e tërmeteve autoktone e që ndodhen në thellësi të caktuara të kores Toksore.

Ky rezultat është faktor tejet më rëndësi, që përcjell vazdimisht aktivitetet sizmike dhe në studimin e përpumimin e masave mbrojtëse prej tërmeteve, pavarisht prej madhësisë së tërmeteve. Prezencia e tërmeteve lokale, edhe atyre me shkallë të ulët, për një rajon, tregon për rrezikun që i kanoset rajonit nga ato.

Në qoftë se e shqyrtojmë hartën e epiqendrave (Fig.3), shihet qartë se me egzistencën e hipocendrave autoktone të tërmeteve karakterizohen rajonet e giera të terreneve si vijon: Ferizaj-Viti-Kacanik, Prishtinë, Skënderaj, Gjakovë-Rahovec-Prizren-Dragash dhe Pejë. Thellësia e hipocendrave të këtyre tërmeteve është e ndryshme, por nuk i kalon të 25 km. Kështu pra, bëhet fjalë për tërmete të cekta, që dëshmon qartazi se edhe tërmetet me shkallë të ulët të intensitetit për shkak të thellësisë së vogël, në sipërfaqe mund të manifestohen me shkallë të lartë të intensitetit. Në bazë të të dhënavë të deritanishme egzistuese, thellësia mesatare e hipocendrave për tërmetet në territorin e Kosovës lëviz në kuftë 10-15 km, por ka edhe raste të tralla, kur nuk ka pasur mundësi të caktohet thellësia e hipocendrës, siç shihet nga katalogu dhe hartat. Thellësia mesatare e hipocendrave të tërmeteve për disa zona epiqendrore, jepet në tabelën e mëposhtme [6,7].

4. SIZMOTEKTONIKA E KOSOVËS

Sintesa dhe analiza e të dhënavë neotektonike dhe korelimi i tyre me të dhënat sizmologjike është parakusht për vlerësimin e aktivitetit sizmotektonik [1,4,10,11]. Proceset e reja tektonike që manifestohen kohë pas kohë si dukuri sizmike, siç janë tërmetet e lidhur me shkëputjet aktive.

Zona Epiqendrore	Ferizaji, Vitia, Kaçaniku	Prishtina	Skënderaj	Peja	Gjakova, Rahoveci, Prizreni, Dragashi
Thellësia e hipocendrës	15	5-10	10	10	20


Studimi i morfollogjisë së shkëputjeve dhe klasifikimi i tyre nga aspekti i vlersimit të rrezikut sizmik ka rëndësi parësore.

Duhet theksuar se të dhënat sizmike egzistuese na japin një informacion të mirë për aktivitetin tektonik të shkëputjeve për një periudhë të shkurtër kohe, dhe siç shihet nga të dhënat sizmike për territorin e Kosovës egzistojnë të dhëna të plota vetëm për shekullin e fundit, ndërsa për periudhën e mëhershme posedohet një dokumentacion vetëm për tërmetet e fuqishëm.

Në bazë të ballafaqimit të të dhënavë egzistuese geologo-neotektonike dhe sizmologjike mund të jepen karakteristikat sizmotektonike të Kosovës më në detaje se sa të dhënat e ofruara nga statistikat sismologjike. Parë në këtë kuqim, këtu do të shtjellohen këto çështje:


1. Zonat e shkëputjeve aktive dhe aktiviteti i tyre sizmotektonik,
2. Zonat e burimeve sizmike.

Fig. nr. 3



4.1. Zonat e shkëputjeve aktive dhe aktiviteti i tyre sizmotektonik

Harta e shkëputjeve aktive të Kosovës



Për territorin e Kosovës është me shumë rëndësi pasqyrimi i shkëputjeve të cilat kanë qenë aktive në etapën më të re të orogenezës Alpine, që kanë kushtëzuar elementet kryesorë neotektonikë dhe janë aktivë edhe tani. Ato janë puthuajse tërësisht shkëputje normale. Shkëputjet neotektonike, të cilat përfaqojnë kufinjtë natyralë të bloqueve morfostrukturore, janë paraqitur në një hartë (Fig. 4), në të cilën ato shënuar me numra prej 01-026, dhe emërtimet e të cilave janë si vijon [6,7]:

- | | | |
|------------------|----------------------|-------------------------|
| 01 Vrellë-Istogë | 011 Zona e Babovcit | 021 Qiqavicë |
| 02 Pejë-Deçan | 012 Kopaonik-Llojanë | 022 Sitnicë |
| 03 Ribnik | 013 Grashthinë | 023 Prishtinë-Gilogofcë |
| 04 Sharr | 014 Slakovicë | 024 Vilasina-Lepencë |
| 05 Ostrovicë | 015 Kaçandollitë | 025 Dubnicë |


07 Radushë
08 Lepenc
09 Obrovac
010 Bellanicë
Shkëputjet më të shprehura në anën veriore, perëndimore dhe jugore të Depresionit të Dukagjinit janë: 01, 02, 03 dhe 06. Me këto shkëputje është i lidhur sismiciteti, i cili këtu është manifestuar në shekujt e fundit. Te gjitha të dhënat tregojnë se shkëputjet e lartpërmendura janë sismogjene dhe bartëse të tërmeteve të fuqishme.

Morfologjia e shkëputjeve dhe raporti i tyre me Depresionin e Dukagjinit dëshmojnë se edhe në të ardhmen në këto treva mund të ndodhin tërmetet me magnitudë 6.0-6.5. Vatra më e rëndësishme sismike e Kosovës është ajo e Vitisë, në të cilën zonë në vitin 1921 ka ndodhur tërmeti më i fuqishëm në Kosovë, me magnitudë 6.2 dhe intensitet IX ballë MSK-64. Egzistanca e shkëputjeve tërthore dhe asaj të Lepencit, prezanca e dukurive vulkanike dhe burimeve të ujраве termal, dëshmojnë për një aktivitet të lartë, ku edhe në të ardhmen mund të priten tërmete me magnitudë 6.0-6.5.

Rajoni i Albanikut (Kopaonikut), në veri të Mitrovicës, ku ka qenë i shprehur vulkanizmi gjatë neogjenit, karakterizohet me aktivitet të lartë sismik, i cili është dëshmuar me tërmetin e vittit 1980 me magnitudë 6.0. Këtu edhe në të ardhmen mund të priten tërmetet me magnitudë 5.5 - 6.0. Gjatë vlerësimit të rezikut sismik kryesisht merren parasysh të dhënat statistikore mbi tërmetet dhe kërkohet llidhja e tyre me strukturat gjeologjike egzistuese.

Kriteri gjeologjik është i llidhur me proceset që janë zhvilluar gjatë etapës neotektonike kur janë formuar njësítë morfostrukturore, bazzament i reliefit të sotëm. Sipas të dhënave egzistuese, që i kemi prezantuar më parë, treva e Dukagjinit përfaqëson pjesën më aktive sizmotektonike të Kosovës. Sipas kriterieve gjeologjike në këtë pjesë të Kosovës mund të ndodhin tërmetet më të fuqishme se sa ata që kanë ndodhur ($M=6.1$, Prizren). Për pjesët e tjera të Kosovës, kriteri gjeologjik nuk na mundëson të japim ndonjë vlerësim i cili do të ndryshojë njohurit e deritanishme mbi aktivitetin sizmotektonik, respektivisht prej njohurive që i kemi prezantuar më herët.

Harta e burimeve sismogjene për Kosovën, duke u mbështetur në tërmetet e goditura 1900-1985 M>3.8



4.2. Harta e burimeve sismogjene në territorin e Kosovës

Kjo hartë (Fig.5) është përpiluar duke u bazuar në harten epiqëndrore me kufinj, në të cilat në aspektin hapsinor tregohen burimet sismogjene. Për këtë arsyre kjo hartë përfaqson gjendjen e ndodhur faktike dhe mbështetet në periudhën 1900-1985. Kjo hartë percakton pozitën, orientimin dhe madhesine e disa burimeve sismogjene. Në brendi të seicës zone është e shënuar magnitudua e tërmetit më të fuqishëm në atë zonë. Në qoftë se e analizojmë këtë hartë, do të shohim se në territorin e Kosovës vëzohen këto burime sismike: Viti-Kaçanik, Prishtinë, Skënderaj, Peje, Gjakovë-Ferizaj, Prizren-Dragash dhe Albanik (Kopaonik). Vlerat më të larta të magnitudës përkatesisht për këto zona janë: 6.2, 3.8, 4.5, 5.1, 5.3, 6.1, 6.0. Në këtë mënyrë me ndihmën e kësaj harte kemi caktuar pozitën, madhësinë dhe orientimin e burimeve prej nga gjenerojnë tërmetet në territorin e Kosovës. Kjo hartë siç do to shihet më vonë, do të gjëjë aplikim konkret në rajonizimin sismik të Kosovës. Siç shihet prej kësaj harte, territori që e kemi emërtuar Viti-Kaçanik përfaqson burimin sismik më të fuqishëm, në të cilin ka ndodhur tërmeti më i fortë autokton, ai i vitit 1921, me magnitudë 6.2 dhe intensitet në sipërifaqe prej IX ballë MSK-64.

5. PËRFUNDIME

Gjatë përgatitjes së këtij artikulli, metodologjia e ballafaqimit të dhënavëve egzistuese sismologjike me të dhënat gjeeologo-neotektonike ka patur përparsëi të ndjeshme [6,10].

Hulumtimet sismotektonike të kryera për territorin e Kosovës dëshmojnë për një potencial të lartë sismik dhe domosdoshmérinë e vazhdimit dhe të intensifikimit të hulumtimeve sismologjike.

Territori i Kosovës përfaqson një rajon të rrrallë të intensifikimit të hulumtimeve sismologjike. Territori i Kosovës përfaqson një rajon të rrallë në aspektin gjeeologjik, të cilin e karakterizon një ndërtim i ndërlikuar gjeeologo-tektonik. Në ndërtimin gjeeotektonik të Kosovës dallohen dy njësi të mëdha. Masa Dardane, në pjesën lindore, dhe Dinaridet e Brendshme në pjesën perëndimore të saj. Territori i Kosovës karakterizohet me një tektonikë tepër intensive, me rrudhosje e shkëputje, shpeshtë drejtim shtrirje VP-JL, si dhe me një veprimtari vulkanik të shënuar. Nisur nga kjo tektonike intensive, kuptohet pse Kosova paraqet një terren tepër aktiv sismik, ku ka gjasa për tu goditur edhe në të ardhmen nga tërmetet të fuqishëm autoktonë. Territori i Kosovës në aspektin sismologjik, përvëç dukurisë së tërmeteve autoktone, i nënshtrohet edhe goditjeve të fuqishme nga tërmetet e largët.

Duke u bazuar në të dhënat e shkullit të XX-të mbi sismicitetin dhe në sintezën sismotektonike të kryer në këtë artikull, janë dalluar këto zona të burimeve sismike në Kosovë: Ferizaj-Viti Kaçanik (tërmeti më i fortë që goditi atë ishte me magnitudë $M=6.2$), Prishtinë ($M=3.8$), Skënderaj ($M=4.5$), Peje ($M=5.1$), Gjakovë-Rahovec ($M=5.3$), Prizren-Dragash ($M=6.1$) dhe Albanik (Kopaonik, $M=6.0$). Nga këto zona të burimeve sismike gjenerojnë tërmetet autoktonë në Kosovë.

Fig nr. 5

LITERATURA

Aliaj, Sh.	1988	Neotektonika dhe Sizmotektonika e Shqipërisë. Disertacion për gradën shkencore "Doktor i Shkencave". Arkivi i Institutit Sizmologjik, Tiranë
Angjelković, M.	1985	Neotectonic structure of Albania. AJNTS, Nr.4
Arsovski, M.	1973	Tektonica rajonizacija Jugoslovije. General characteristics of neotectonic structure
Arsovski, M.	1974	on the territory of Yugoslavia. Seminar on Seismotectonics of Balkan Region. Dubrovnik, Problemi neotektonike Jugoslavije. Jugoslovenski Geoloski Kongres, Bled, 1974.
Elezaj Z.	2001	Tiparet themelore sizmotektonike të Kosovës. Mikroteza, Fakulteti Gjeologji-Miniera, Universiteti Politeknik, Tiranë.
Elezaj Z.	2001	Karakteristikat kryesore sizmotektonike të Kosovës. Referat i mbajtur në Konferencën e 3-të Kombëtare "Gjeomjedisi 2001", Tiranë 23-24 Shtator 2001.
Stojković, M. Mihajlov, V.	1976	Seismicko reoniranja na territoriat e SR Makedonija, Skopje, 1976.
Sulstarova, E., Koçiaj, S.	1975	Katalogu i tërmeteve të Shqipërisë. Akademia e Shkencave Tiranë.
Sulstarova, E., Koçiaj S.,	1980	Rajonizimi sizmik i Shqipërisë (shqip e anglisht).
Aliaj, Sh.		Shtypshkronja "Mihal Duri" Tirane.
Sulstarova, E., Aliaj Sh.	2001	Seismic hazard assessment of Albania. Nr. 10, 2001.

ABSTRACT

The combination of seismological data with geological ones has the priority during this seismotectonic analysis. The seismotectonic investigations carried out in Kosova show a high seismic potential. Two large units are distinguished in Kosova geotectonic framework: Dardan Masse in eastern part and Inner Dinarides in western one. The Kosova territory represents a rare geological region, characterized by intensive folding and faulting, generally NW extending, and by a marked volcanic activity. It represents an active seismic area, where the strong earthquakes have occurred and can also occur in the future.

Based on the XX century data of seismicity and on the seismotectonic synthesis, the following seismic source zones are distinguished in Kosova: Ferizaj-Viti-Kaçanik ($M=6.2$), Prishtinë ($M=3.8$), Skënderaj ($M=4.5$), Pejë ($M=5.1$), Gjakovë-Rahovec ($M=5.3$), Prizren-Dragash ($M=6.1$) and Albanik (Kopaonik, $M=6.0$). From these seismic source zones can be generated in the future the earthquakes in Kosova.

PROBLEME HIDROGEOKIMIKE TË UJERAVE TË VENDBURIMEVE KARBONATIKE TË NAFTËS TË SHQIPËRISË

Xhezmi XHEMALAJ

Hyrje

Përberja kimike e ujrate të vendburimeve të naftës nuk është e njëjtë. Ato nuk janë formuar nga një evaporm apo hollim i tjtheshtë i ujut të sedimentimit (në rastin e karbonateve nga uji i detit). Përqëndrimet dhe raportet e përbërsve të tretur në ujrat e vendburimeve të naftës varen nga origjina e ujit dhe nga çka ndodhur me të (ujin) që kur ai hyn në ambient nëntokso. Për shembull, disa ujra janë kurtuar qysh gjatë sedimentimit, ujra të tjerë kanë infiltruar nga sipërfaqja nëpërmjet çveshjeve sipërfaqsore të kuşhtëzuara nga zhvillimi gjeologjik i rajonit, disa ujra janë përzjerje të ujrate të sedimentimit me ato të infiltrimit dhe të gjithë këta, gjatë jetës së tyre të përbashkët kanë dhënë e marrë me shkëmbin dhe hidrokarburet duke modifikuar përbjerjen e tyre.

1. SHPËRNDARJA E BENZENIT DHE HOMOLOGEVE TË TIJ NË UJRAT E VENDBURIMEVE TË NAFTËS

Nga gjithë treguesit organik të analizuar, benzeni dhe homologet e tij në ujra kanë një rëndësi të veçantë. Rëndësia e tyre lidhet me vet kërkimin e naftës. Metodika e marties, analizimit dhe përpunimit të të dhënavës është dhënë në një artikull tjetër (5), për pasojë nuk po zgjatem më tej. Benzeni dhe homologet e tij janë përcaktuar me gazkromatograf të markës Carlo Erba 4200 me detektor me flakë jonizimi.

1.1 PËRMBAJJA E BENZENIT NË HORIZONTET JOPRODUKTIVE

Përbajtja e benzennit në rajonet me qarkullim aktiv ujrrash është zero. Vlera të tillë takohen në ujrat e depozitimeve të suitës "Rrogzhina" (N^2) e depozitime të mesinianit (N^3), në burime sipërfaqsore, qënë kështu dëshmi të prejardhjes së benzennit takohen në disa burime sipërfaqsore, duke ujrrash, si në Kalcat, Butrint, etj.

1.2 SHPËRNDARJA E BENZENIT DHE HOMOLOGEVE TË TIJ NË UJRAT E VENDBURIMEVE TË NAFTËS

Në përgjithësi takohen një diapazon i gjërë i vlerave të përbajtjes së benzennit në ujrat e vendburimeve tonë të naftës, por ato asnjëherë nuk bëhen zero. Ndërsa, për homologët e benzennit (0.003 deri 0.7 mg/lit) janë marrë edhe në disa puse që kanë kapur zonën e sipërmë me qarkullim intensiv

Vlerat më të ulta takohen në ujrat e vendburimeve të Drashovicës, Visokës, Ballshit dhe vlera më të larta në ujrat e vendburimeve të Mollajt, Kallmit, Amonices, Gorrishtit dhe Kuçovës(tab.1). Fraksioni deri në 200°C , aromatik në fraksionin deri 200°C , dhe aromatik ndaj naftës shprehen në % në peshë

Krahasimi i vlerave të përbajtjes së benzennit në ujra është bërë në varësi të kuşteve hidrogeologjike të ndodhjes së vendburimeve dhe veticë fiziko-kimike të naftave të tyre, të shprehura këto me treguesit e mineralizimit të përgjithshëm, temperaturës së shtrresës dhe thellësise mesatare të shtrirjes së vendburimeve, etj., (tregues këto të kuşteve hidrogeologjike të shtrirjes së vendburimeve) dhe përbajtjes së fraksionit deri në 200°C dhe përbajtjes së aromatikëve të radhës së benzennit në fraksionin deri në 200°C , (tregues këto të veticë fiziko-kimike të naftave).

Duhet theksuar se, veçori të tillë si kuştet e qeta hidrogeologjike, pra thellësi e madhe shtrirjeje, temperaturë dhe mineralizim i rritur, u korespondojnë vleramë të larta të përbajtjes së aromatikeve të radhës së benzennit të tretur në ujra dhe e kundërtë. Kështu, psh, në ujrat e vendburimeve të Mollajt, Amonices, Gorrishtit, takohen vlera më të larta të benzennit dhe homologëve të tij, dhe e kundërtë vërehet në ujrat e vendburimeve Vurg, Ballsh, Visokë, Driza, Drashovicë me qarkullim

Tabele 1 - Treguesit kryesor hidrogeokimik të vendburimeve të naftës

Treguesit	Vendburimet e Naftës								
	Vurgu	Ballshi	Visoka	Gorishi	Koculi	Amonica	Sheqisht	Kallm	Mollaj
Thellesia(m)	1663	1211	1543	1019	1299	2527	1828	2320	3455
Temperatura(°C)	33,5	37,2	45,3	33,4	39	54	50	58	66,5
Mineralizimi(gr/lit)	20	23,8	15,9	85	95	87	34	37	90
Densiteti naftës	0.982	0.9985	1.0143	0.9591	0.9573	0.9013	0.9944	0.9737	0.9379
Frakzioni deri 20°C	3,76	9,42	7,86	11,05	10,99	17,85	6,72	8,85	13,41
Aromatik ne fr.200°C	5,75	15,47	15,21	13,6	15,24	12,28	19,05	24,45	20,94
Aromatik ndaj naftës	35,9	40,1	42,8	36,5	36,9	32,1	40,7	38,1	34,3
Aromatik ne ujë(mg/l)									
Benzen	0,704	0,467	0,81	1,086	0,2	2,703	2,42	4,344	5,868
Toluën	0,16	0,643	0,84	0,96	0,41	0,765	0,477	0,571	4,375
Etilbenzen	gj	0,277	0,16	0,2	0,086	0,114	0,16	0,071	0,347
Paraksilene	gj	0,145	0,13	0,12	0,037	0,089	0,137	0,057	0,4
Metaksilene	gj	0,216	0,24	0,15	0,083	0,093	0,247	0,114	0,933
Ortoksilene	gj	0,22	0,18	0,16	0,079	0,11	0,158	0,085	0,747

Shenim:
gj. - gjurmë (vlera me te vogla se 0,001 mg/lit)

më të madh ujash.

Analiza korelativë midis përbajtjes së hidrokarbureve aromatike në ujra dhe përbajtjes së shumë kur krahasojmë përbajtjen e aromatikëve në ujra me produktion: përbajtja e frakzionit deri në 200°C, flet për një varësi lineare. Koeficientet e korelacionit rriten akoma më në 200°C me përbajtjen e aromatikëve në ujra me densitetin e naftës, shoqëron përbajtjen naftën me të cilin ato kontaktojnë. Me fjalë të tjera: rritja e densitetit të naftës, shoqëron përbajtje të ulët të frakzionit deri në 200°C dhe produkt përbajtje e frakzionit deri në 200°C, përbajtja e aromatikëve në këtë fraksion të ulët, faktorë këto që çojnë në vlera të ulta të aromatikëve në naftë dhe për pasojë në vlera të ulta të përbajtjes së aromatikëve të tretur në këto ujra dhe anasjelltas.

Raporti toluen/benzen në nafta është i lartë, gjithmonë më i lartë se 1(mesatarisht 5,5 në naftat e vendit tonë), ndërsa po ky raport në aromatikët e tretur në ujë rezulton rreth vlerës 1. Ndryshimi i dukshëm spiegohet me tretshmëritë e ndryshme të benzenit dhe toluenit në ujë. Benzeni tretet 3,3 herë më shumë se tolueni dhe për pasojë raporti toluen/benzen në ujë zgogëlohet në mënyrë të dukshme nëë krahasin me po këtë raport në benzинat. Raportet e tjera: metaksilene/ortoksilene dhe paraksilene/ortoksilene në ujrat e vendburimeve të naftës dhe në benzинat janë thuajse të përafërtë pasi edhe tretshmëritë e këtyre homologëve janë thuajse të njëjtë.

1.3 Kriteret e përdorimit të benzenit dhe homologëve të tij në kërkimin e naftës.

Mbështetur në analizën e bërë mbi shpërndarjen e benzenit dhe homologëve të tij në ujra rezulton:

- Vlera zero të përbajtjes së benzenit takohen vetëm në horizontet joproductive dhe larg shtratimeve të naftës.
- Në ujrat e vendburimeve të naftës nuk takohen vlera zero të përbajtjes së benzenit. Por në ujrat e vendburimeve të naftës takohen vlera zero të përbajtjes së homologëve të benzenit si etilbenzeni dhe ksilenet. Kjo lidhet me vëtitë fiziko-kimike të naftave me të cilat kontaktojnë këto ujra. Kështu vlera zero për homologët e përmendur takohen në vendburimin e Drashovicës, në ujrat e pjesës veriore të vendburimit te Visokes, ne ujrat e piesës jugore te "Drizave" dhe ne ato të vendburimit të Vurgut. Vlerat zero lidhen me faktin e kontaktimit të këtyre ujrate ujrate me nafta të renda të biodegraduara.

- Në ujrat e zonës së sipërme hidrogeologjike me qarkullim intensiv ujrush në kompleksin karbonatik takohen vlera të ulta të përbajtjes së benzenit. Duhet theksuar se kompleksi të benzenit liuhën me tretshmërinë e lartë të tij në ujë. Vlera të ulta të përbajtjes së benzenit takohen edhe në ujrat e thellësisë larg kontaktit me naftën, si në puset e Vanës, Sasaj dhe Treblovë.
- Me afimin drejt shtratimit, vlerat e përbajtjes së benzenit në ujë riten shumë. Kështu në ujrat e kontaktit anësorë të vendburimit të Amonicës kapen vlera 0,29 mg/lit; Kreshpanit 1,42 mg/lit dhe Visokës 0,27 mg/lit. Vlera këto që tentojnë të arrinë vlerat e benzenit të kapura në ujrat e këtyre vendburimeve. Po kështu edhe në vertikalitet me afimin drejt kontaktit naftë-ujë vlerat e benzenit rriten.
- Vlerat e benzenit dhe të homologëve të tij në ujra duhen gjykuar në bashkësi me të gjithë aromatikëve në frakzionin deri në 200°C, të kushteve hidrogeologjike të ndodhjes së tyre, të veçoriive hidrokomike ,etj. Në fund të fundit, sa më shumë ti afrohet vlera e benzenit të kapur në ujrat e marra në një plus kërkimi, vlerës së përbajtjes së benzenit në ujrat e vendburimeve (për kushte të ngashme hidrogeokimike), aq më afér shtratimit të naftës ndodhet pusi i shpuar.

2. ASPEKTE HIDROKIMIKE TË UJRAVE TË VENDBURIMEVE TË NAFTËS

Ujrat e vendburimeve të naftës karakterizohen nga një diapazon i gjerë i përqëndrimeve të joneve të tretur në to. Kështu, në bazë të mineralizimit të përgithshëm (tab.2), ujrat e vendburimeve të naftës grupohen në:

- a. ujra me mineralizim të vogël, ku futen ujrat e vendburimeve Bubullimë e Kolonjë, me vlera 36- me vlera mesatare 15 - 25 gr/lit.
 - b. ujra me mineralizim mesatar, ku futen ujrat e vendburimeve Cakran, Gorrisht, Amonicë, Mollaj, 42 gr/lit.
 - c. ujra me mineralizim të lartë, ku futen ujrat e vendburimeve Cakran, Gorrisht, Amonicë, Mollaj, Koculi dhe Gerneç me vlera 65 - 100 gr/lit.
- Po kështu, sipas raportit i NaCl ujrat e grupuara në “a” kanë vlera të larta të këtij rapporti dhe për Tabele 2- Treguesit kryesor hidrokomik të ujrave të naftës

Nr	Vendburimi	Pusi	Thellesia(Na+K)(m)	Treguesit hidrokomik kryesor të ujrave të vendburimeve të naftës							
				rCa mek/lit	rMg mek/lit	rCl mek/lit	rSO4 mek/lit	rCO3 mek/lit	rHCO3 mek/lit	Iod mg/lit	Brom mg/lit
1	Vurgu	Vu-14	1900	352,7	1,5	22	295	0	36	45,6	2,1
		Vu-18	1650	395,6	12	19	365	1,6	0	60	2
2	Ballshi	Ba-15	1730	236	10	11	240	0,69	1,6	15,3	20
		Ba-52	1300	545	122	48	660	32	0	23,6	12,4
3	Hekalii	Kb-17	1850	301	18	22	300	1,3	0	41	2
		He-21	1925	242	14	20	230	2	0	44,2	1
4	Visoka	651	1015	39	0,7	1,7	4,2	1,2	1,2	6,5	0
		641	1900	564	40	29	610	18	0	4,9	0
5	Gorishi	Go-2	1500	1512	92	54	1595	35	36	21	70
		Go-92	1400	1213	70	58	1260	38	0	43,2	22,5
6	Koculi	Ko-11	1650	1107	112	24	1190	24	0	28,8	24,6
		Ko-29	1300	1487	122	36	1575	34	0	36	25
7	Gerneci	Ko-17	1830	1349	98	40	1420	34	0	36,6	18
		Gr-5	2300	1565	122	50	1670	34	0	33	1,6
8	Amonica	Am-2	2750	1213	61	44	1280	5	0	33	7,6
		Am-24	2450	1427	142	36	1540	40	0	25	1,6
9	Cakran	Ca-22	4200	1125	684	36	1155	26	0	48,4	13,5
		Ca-25	3550	1061	48	28	1070	26	0	41,6	20
10	Mollaj	Mo-1	3560	1419	154	47	1565	22	0	33	5,6
		Mo-2	3550	1268	200	36	1440	40	0	24	3
										180	210
											85,3

pasoje tipi kimik rezulton sulfat dhe hidrokarbonat - natriumi, ndërsa ujrat e grupeve "b" dhe "c" karakterizohen nga vlera të vogla (<1) të këtij reporti dhe për pasoje u përkasin tipeve kloro - magnezial dhe kloro - kalcitik.

Raporti ndryshimi i mineralizimit të përgjithshëm me thellësinë e ndodhjes (dMp/dz) se këtyre shumë më i lartë për ujrat e grupit të dytë dhe të tretë. Këto karakteristika shprehin në një farë mase shkallën e mbylljes hidrogeologjike dhe në fund të fundit lidhen me kushtet e ruajtjes së grumbullimeve të naftës. Këto kushte përmirsohen duke shkuar nga "a" drejt "b" dhe "c".

Sipas përbajtjes sulfatet dallojme:

- a- ujra me përbajtje sulfatesh më pak se 1%. Këtu futen ujrat e vendburimeve Vurg, Hekal, Bubullimë, Kolonjë, Visokë.

b- ujra me sulfatë 1 - 2%, futen ujrat e vendburimeve Ballsh e Cakran.

c- ujra me sulfate mbi 2%, futen ujrat e vendburimeve Kocul, Mollaj, Amonicë, Gërmec e Gorisht. Përgjithësisht vlerat e larta të sulfateve shoqërohen me vlera të ulta të karbonateve dhe e kundërtë, duke ilustruar kështu fenomenin e reduktimit të sulfateve, pasurimin e ujërave me bikarbonatet dhe gaz sulfhidrik, fenomen që mund të zhvillohet vetëm në prani të bakterieve (psh. sporovibrio desulfuricans). Duhet përmendur që midis përbajtjes së sulfateve në ujra, gazit sulfidrik dhe squfurit të përgjithshëm në naftë ka lidhje reciproke. Raportet e tjera rNa/rMg dhe rCa/rMg flasin në një farë mase për proceset e dolomitizimit në shkëmb dhe kontaktit të ujave me këto shkëmbinj.

3. KRAHASIMI I UJRAVE TË VENDBURIMEVE TË NAFTËS ME UJIN E DETIT TË EVAPORUAR

Lidhjet midis bromit dhe mineralizimit të përgjithshëm mund të përdoren për të përcaktuar originën e disa ujave, veçanërisht atyre ujave që ja detyrojne kripshmërinë e lartë të tyre tretjes së shkëmbinjve evaporitikë ose evaporitit. Njohja e ujave të tillë do të ndihmonte për një kuptim më të mirë të lëvizjes apo jo të ujave në zonat ku ato ndeshen.

Bromi, kryesisht në trajtën e jonit Br⁻ takohet në ujrat e vendburimeve tonë të naftës në vlera 1 - 300 mg/lit. Në përgjithsi, vlera e tij rritet me rrjeten e mineralizimit. Disa ujra me mineralizim më të lartë se uji i detit janë deficente në brom, të tjera me kripshmëri të lartë shoqërohen me depozitine kripore. Prania e ujave të tillë tregon se kemi pak ose hiç fare lëvizje të këtyre ujaveve. Si bazë për interpretimin e rëndësise gjenetike përdoret varësia: $Br = f(Mp)$. Në ujin e detit, sipas SMOW kemi: $Br = 65 \text{ mg/lit}$, dhe $Mp = 35 \text{ gr/lit}$.

Dihet që gjatë precipitimit të NaCl përbajtja e bromit shkon deri 500 mg/lit (0.05% të solucionit) dhe me precipitimin e NaCl, një pjesë e bromit zëvendëson klorin në kristale. Për më tepër dihet që:

- Faktori i shpërndarjes $F = \% \text{ peshe } Br (\text{në kristale}) / \% \text{ peshe } Br (\text{në solucion ujor})$ është relativist i vogël (0.073-0.16).

- Ky report mbetet konstant për përqëndrime të bromit deri në 1% ose më shumë.
- Ky rapport nuk ndryshon shumë me rrjeten e temperaturës nga 25 deri 83°C .
- Ky rapport zvogëlohet ndërsa magneziumi në solucion rritet.

Hollimi, përziera e ujit të detit me ujë të ëmbël në të cilin përbajtja e bromit është shumë e vogël, çon si në uljen e mineralizimit ashtu edhe të përbajtjes së bromit. Sa më i ëmbël të jetë uji, aq më shumë kurba i përafrohet këndit 45° (fig.1). Rritja e mineralizimit në ujin e ëmbël bënë që rruga e hollimit të zhvendoset progresivisht në të majtë. Teorikisht dallohen këto grupe(5) në bazë të varësise $Br = f(Mp)$.

- Ujra, në të cilat përbajtja e bromit dhe mineralizimit ecin sipas kurbës së evaporimit të thjeshtë të ujut
- Ujra, të cilët kanë dy herë më shumë brom për një vlerë të dhënë të mineralizimit. Pra me fjalë


të tjera janë ujra për të cilat pozicioni i tyre në grafikun e lartpërmendor tregon një zhvendosje në të djathëtë dhe lidhen me diagjenezin e hershme. Në grupin e tretë futen ato ujra që kanë mineralizim më të lartë se ai i ujut të detit, por përbajtja e bromit është më e ulët se ç'pritet nga përqëndrimi (evaporimi) i thjeshtë i ujut të detit. Deficiti ne brom flet për tretjen e halitit të depozitimeve evaporitike.

- Futen ato ujra që kanë mineralizim më të vogël se uji i detit, por brom kanë më pak se ç'pritet nga një hollim i thjeshtë i ujut të detit me një ujë me mineralizim të ulët dhe përbajtje të ulët të bromit.
- Grupi i pestë përfshin ujëra me kripshmëri dhe përbajtje bromi të lartë, më të lartë se ato të grupit të dytë. Këtu futen, psh ujrat e Detit të Vdekur.

Sipas ndërtimit të tjerë (fig 1), ujrat e vendburimeve tonë të naftës mund të grupohen në dy ndarje të mëdha:

- I. Ujra me kripshmëri aktuale më të ulët se uji i detit dhe,
- II. Ujra me kripshmëri aktuale më të lartë se uji i detit.

Këto grupime janë në sense të kundërtë dhe janë shprehje e proceseve post sedimentare në shkëmbinjë karbonatik dhe konkretisht shprehin hollimin apo përqëndrimin e ujut të detit të sedimentimit. Nga ana tjeter, hollimi dhe përqëndrimi lidhen me shkallën e mbylljes gjeologjike të strukturave. Strukturat me mbyllje të vogël shoqërohen me ujra me mineralizime të ulta dhe përbajtje ($J + Br$) të ulët. Pra, në to evidentohet procesi i infiltrimit të ujave meteorike në thellësi, përzjerja e tyre me ujrat e sedimentimit dhe për pasoje kemi modifikimin e përbajtjeve kimike të tyre në sensin zvogëluar. Ujrat e këtyre strukturave përbëjnë grupin e parë e përfaqosohen me ujrat e vendburimeve Finiq.



Kranë, Visokë, Ballsh, Hekal.

Shikohet se shpërhapja e këtyre ujравe në grafikun bilogaritmitik të kurbës së evaporimit eshtë e madhe dhe kryesisht në anën e majtë të saj, duke u paraqitur me vlera më të ulta të përbajtjes së (Br+J) se sa do të pritej nga një hollim i thjeshtë me ujë meteorik.

Këto ujra janë formuar ose nga hollimi i ujit të detit me ujë me kripshmëri relativisht të lartë, por me vlera të ulta të bromit ose kanë qënë ujra me mineralizime më të larta se uji i detit, por përbajtja e bromit ka qënë e ulët, pra kanë qënë karakteristike për depozitimet kripore (halit). Kjo eshtë karakteristike për ujrat e vendburimeve Finiq-Kranë, Ballesh, dhe disa ujra të vendburimit të Visokës.

Ndërsa pjesa dërmuese e ujравe të vendburimeve të Ballshit e Visokës i përgjigjen një hollimi të thjeshtë, pra kemi një përzjerje të ujравe të sedimentimit me ujra me mineralizim e përbajtje të ulët bromi, duke u bërë indikator të lëvizjes së ujравe në kohën e sotme.

Në gupin e dytë futen ujrat e vendburimeve Gorrisht-Kocul, Gernec, Cakran, Kreshpan, Mollaj, Amonice. Këto ujra paraqesin një shpërhapje të vogël në grafikun bilogaritmitik, pra dhe i përgjigjen një përqëndrimi të thjeshtë të ujit të detit. Më karakteristike kjo rezulton për ujrat e vendburimeve Amonicë, Mollaj, Gernec, Cakran.

Një shpërhapje më e madhe vihat re për ujrat e vendburimit Gorrisht-Kocul, me prirje për t'u lokalizuar në të majtë të kurbës. Me fjalë të tjera këto ujra çfaqin mineralizime me të larta se ç'pritej nga përbajtja e bromit. Në këtë rast kemi të bëjmë me ndikimin e ujравe të thellësisë me mineralizime të larta e përbajtje bromit të ulët. Ky interpretim mbështetet edhe nga ndërtimi gjëologjik i rezervuarit karbonatik të "Gorrishit".

Si përfundim, ujrat e vendburimeve tonë të naftës në bazë të varësisë Br=f(Mp) mund të ndahanë në dy grupe të mëdha dhe secili grup në dy nëngrupe:

I/1. Ujra me mineralizim dhe përbajtje të bromit në përputhje me kurbën e evaporimit, por në sensin e hollimit, domethënë janë formuar si pasojë e hollimit të thjeshtë me ujë meteorik. Këtu futen ujrat e vendburimeve Ballsh dhe Visokë.

I/2. Ujra me mineralizim të përgjithshëm më të lartë se sa pritet nga përbajtja e bromit (Finiq-Kranë dhe disa ujra të vendburimeve Visokë, Hekal, Ballsh). Këto ujra kanë patur kripshmëri më të lartë se uji i detit por përbajtje bromit të ulët dhe janë holluar nga përzjerja me ujë meteorik.

II/1. Ujra me mineralizim dhe përbajtje bromit në përputhje me kurbën e evaporimit. Për këto ujra është karakteristikë një evaporim i thjeshtë i ujit të detit. Këtu futen ujrat e vendburimeve

II/2. Ujra me mineralizim më të lartë se ç'pritet nga vlerat e bromit. Në këtë rast kemi të bëjmë me një përzjerje të ujравe të thellësisë me mineralizim të lartë e pak brom të depozitimeve kripore ndodhur me këto ujra gjatë historisë gjeologjike.

Amonicë, Gernec, Mollaj, Cakran.

Nga sa thamë më sipër, del në pah rëndësia e grafikëve bilogaritmik për të spjeguar disa nga proceset gjeologjike të ndodhura në rajon. Në bazë të tyre mund të përcaktohet origjina e ujравe dhe ç'ka ndodhur me këto ujra gjatë historisë gjeologjike.

Ndërsa në bazë të varësisë bilogaritmike Cl=f(Na), ujrat e vendburimeve tonë ndahanë në dy grupe, duke shprehur kështu hollimin apo përqëndrimin e ujit të detit të sedimentimit. Dhe për pasojë ndihmon në kuptimin e proceseve të ndodhura gjatë kohës gjeologjike.

Në grupin e parë futen ujrat e vendburimeve Ballsh, Hekal, Finiq-Kranë, dhe një pjesë e ujравe të vendburimit të Visokës. Në grupin e dytë futen ujrat e vendburimeve Gorrisht - Kocul, Amonicë, Gernec, Cakran, Mollaj, me shkallë mbylljeve hidrogeologjike më të madhe se ato të grüpuit të parë.

Në bazë të varësisë Cl=f(Ca), ujrat e vendburimeve Hekal, Ballsh, Finiq-Kranë. Për më tepër, ujrat e vendburimit Finiq - Kranë kanë pak kalcium nga ç'pritet nga përbajtja e klorit.

Në grupin e dytë futen ujrat e vendburimeve Gorrisht-Kocul, Amonicë, Gernec. Këto ujra kanë më shumë kalcium nga ç'pritet. Ndaria e tyre në dy grupe lidhet thuajse gjithmonë me të njëjtë faktorë

të lartpërmendur.

Nga sa thamë, rezulton rëndësia e këtyre grafikëve. Në bazë të tyre mund të përcaktohet origjina e disa ujравe edhe në mjaft puse të kërkimit.

Kështu, në grupin e I mund të futen ujrat e marra në puset Kb-14, 25 që përfaqsojnë ujë deti me ndryshime në të dy sensem dhe ato Zh-2, Vu-22, Kb-17 me mineralizime më të larta se c'pritej nga një hollim i thjeshtë i ujit të detit, pra janë përzjerje të ujit të detit me ujë meteorik që flet për rajone me lëvizje ujërash. Një rast të veçantë përbën uji i marrë në pusin Fit-11, që përfaqson thjesht ujë meteorik.

Në grupin e II futen ujrat e marra në puset Ro - 4, Del - 9, Kb - 34, Ka - 2, Kb - 35, Va - 2, Ro - 3, Gl - 2, Del - 4, Mall - 1, Re - 4, etj., përbëja kimike e të cilëve lidhet me ujin e sedimentimit dhe depozitimet kripore, dhe ujrat e marra në puset Tr - 19, Se - 4, Gl - 1/b, Kb - 1, A - 1 dhe Sel-30 që përputhen me kurbën e evaporimit në sensin e përqëndrimit, pra janë ujra deti të metamorfizuara.

4. KRAHASIMI I UJRAVE TË VENDBURIMEVE ME ATO LARG DHE AFËR TYRE

Sasi të dhe raportet e përbërsve të tretur në ujrat nëntokësore varen nga origjina e tyre dhe nga çka ndodhur me ta gjatë historisë gjëologjike që kur ai hyn në njedis nëntokso. Kuptohet që origjina e ujrit të sedimentimit të karbonateve eshtë e njëjtë, atëherë faktori bazë që bën të ndryshojnë ujrat e vendburimeve nga njeri tjetri, ujrat e vendburimeve nga ato larg dhe afër tyre janë proceset që kanë ndodhur gjatë historisë gjëologjike, janë në fund të fundit ato faktorë që lidhen me kushtet e ndodhjes së këtyre ujраве. Pra, ujrat me histori të njëjtë gjëologjike, me kushte shtrirjeje të ngjashme do të reflektojnë përbëje kimike dhe raporte të ngjashme të përbërsve të tyre. Le të hetojmë këtë nga shtrirja apo dallim të ujраве të vendburimeve, të atyre larg dhe afër tyre me anë të analizës së funksionit dallues. Analiza e funksionit dallues konsiston në gjetjen e një transformimi i cili jep report minimal të diferençave midis një çifti grupesh mesataresh shumëvariabëshe në një variancë shumëvariabëshe brenda dy grupeve.

Për të tre grupet e ujраве, brenda vendburimit, afër vendburimit kemi të njëtin numër treguesish. Shtrohen pyetjet:

- Më këta tregues, a mund të gjemjë ndonjë ndryshim midis grupeve?
- Nëqoftëse ekziston ky ndryshim, a është i qëndrueshëm?
- Dhe e fundit, si mund të tregohet ky ndryshim?

Problemi është të gjemjë një kombinim linear të këtyre treguesve të zgjedhur, i cili të na jep diferençë maksimale midis dy grupeve të përcaktuar më parë. Në qoftë se gjemjë një funksion i cili na jep një ndryshim të dukshëm, atëherë në mund të përdorm atë për të përcaktuar originën, apo grupimin e mostrave të reja të ujit me origjinë të panjohur në një nga këto grupe. Me fjalë të tjera, mostrat e reja mund të kategorizohen në një nga këto grupe mbi bazën e funksionit linear dallues të komponentëve të tyre gjekimnik.

Funksioni linear dallues transformon bashkësinë e treguesve të një kampioni në një pikë të vetme. Kjo pikë, ose këto variabla përfaqsojnë pozicionin e kampionit gjatë një vijë të përcaktuar nga funksioni dallues. Duke transformuar të gjithë treguesit në një pikë të vetme, jemi në gjendje të flasim më mirë për pozicionin e saj.

Treguesit e marrë në shpyrtim janë $r\text{Na}$, $r\text{Ca}$, $r\text{Mg}$, $r\text{Cl}$, $r\text{SO}_4$, $r\text{CO}_3$, $r\text{HCO}_3$, J , Br , B , Mp . Konkluzionet e analizës së funksionit linear dallues përtë tre grupimet; brenda, afër dhe larg shtratimeve të naftës jepen më poshtë.

Duhet përmendur që me termin "brenda" konsiderohen ujrat e marra në puset e nxjerrjes se naftës, puse që janë ujë në procesin e nxjerrjes së naftës. Me termin "afër" konsiderohen ujrat e marra në puset në periferi të shtratimeve në distanca të afëria. Në këtë puse është marre vetëm ujë. Ndërsa me termin "larg" konsiderohen ujra të marra në puset e kërkimit larg shtratimeve të naftës (4).

- Për grupet "brenda" dhe "larg" vendburimeve ato ndahan mirë.

Kështu, në qoftë se shënojmë me R_1 - vlerën qëndrore të grupit të parë, me R_2 - vlerën qëndrore të grupit të dytë dhe me R_0 - vlerën kufitare që ndan dy grupet atëhere kemi:

$$R_1 = 26.97, R_2 = 5.55, R_0 = 17.3.$$

Kontributin më të madh e japon variablat $M_p, rCl, rNa, rSO_4, rCa, rNa, rCl$, dhe mandej treguesit: $rHCO_3, rSO_4, rMg, rHCO_3, rCa$.

- Për grupet "afër" dhe "brenda" vendburimeve, ato ndahen, por ndarja është e dobët. Kështu:

$$R_1 = 8.41, R_2 = 2.76, R_0 = 5.6.$$

Kontributin më të madh e japon variablat $M_p, rCl, rNa, rMg, rHCO_3, rCa, rHCO_3, HCO_3$, më vonë janë përcaktuar edhe mikroelementët Jod, Brom, Bor, dhe NH_4 , por edhe H_2S , Stroncium, Litium, etj.

Krahas tyre, përcaktimet e lëndës organike të tretur në ujëra, si acidet naftenike, karboni organik, karboni organik bituminoz, fenollet, oksidueshmëritë jodate dhe permanganate, benzeni e homologet e tij, etj., kanë plotësuar kështu gjithë treguesit e mundshëm hidrogeokimik, karakteristike të bashkëveprimit ujë - shkëmb - hidrokarbure.

Për sa më sipër, ndryshim më të madh në pikpamje statistikore (me siguri 95%) kanë ujrat e grupeve "afër" dhe "brenda" me ato "larg" shtratimeve. Duhet theksuar se ky ndryshim është një ndryshim statistikor, pra edhe rëndësia dhe siguria e tij janë statistikore. Megjithatë, ky rezultat i nxjerrë statistikisht mbështetet nga proceset e mundshme që ndodhin apo kanë ndodhur në sistemin ujë-shkëmb-hidrokarbure.

Kështu nga të gjithë treguesit, kontributin më të madh në ndarjen e grupeve e japon jone të tilla si HCO_3, SO_4, Ca, Na , etj., nga të cilët tre të paret e kemi përmendur tashmë që vijnë nga procesi i reduktimit të sulfatave.

Konkluzione

- Sipas problemeve të trajtara, ujrat e vendburimeve të naftës kanë veçori karakteristike, që lidhen me proceset që ndodhin në sistemin ujë-shkëmb-hidrokarbure në kushte të ndryshme gjeologjike. Përqëndrimet dhe raportet e përbërësve të tretur në ujrat e vendburimeve të naftës varen nga origjina e ujit dhe nga çka ndodhur me të (ujin) që kur ai hyn në ambient nëntokso. Studimi i hidrokarbureve aromatike të tretur në ujra është mjaft i rëndësishëm. Benzeni dhe homologët e tij në ujra flasin për një lidhje shumë të ngushtë me kushtet hidrogeologjike të ndodhjes së vendburimeve dhe vetive fiziko-kimike të naftave që shoqërojnë këto ujra, të shprehura këto me treguesit e analizuar. Në fund të fundit, sa më shumë ti afrohet vlera e benzenit të kapur në ujrat e marra në një pus kërkimi, vlerës së përbajtjes së benzenit në ujërat e vendburimeve, për kushte të ngashme hidrogeokimike, aq më afër shtratimit të naftës ndodhet pusi i shpuar.
- Lidhjet midis bromit dhe mineralizimit të përgjithshëm mund të përdoren për të përcaktuar originën e disa ujrade. Ujrat e vendburimeve tonë të naftës në bazë të varësisë $Br=f(M_p)$ ndahen në dy grupe të mëdha dhe secili grup në dy nëngrupe, ndarje që flasin për origjinat e këtyre ujrade dhe për proceset gjeologjike - hidrogeologjike që kanë ndodhur në këto rajone.
- Sasitë dhe raportet e përbërësve të tretur në ujrat nëntokso varen nga origjina e tyre dhe nga ç'ka ndodhur me ta gjatë historisë gjeologjike. Kuptohet që origjina e ujit të sedimentimit të karbonatave është e njëjtë, atëherë faktori bazë që bën të ndryshojnë ujrat e vendburimeve nga njeri tjetri, ujrat e vendburimeve nga ato larg dhe afër tyre janë proceset që kanë ndodhur gjatë historisë gjeologjike, janë në fund të fundit ata faktore që lidhen me kushtet e ndodhjes së këtyre për treguesit e shqyrtuar, tregon se ndryshim më të madh në pikpamje statistikore (me siguri 95%) kanë ujrat e grupeve "afër" dhe "brenda" me ato "larg" shtratimeve. Ky rezultat i nxjerrë statistikisht mbështetet nga proceset e mundshme që ndodhin apo kanë ndodhur në sistemin ujë-shkëmb-hidrokarbure. Kështu, nga të gjithë treguesit, kontributin më të madh në ndarjen e grupeve e japon jone të tilla si HCO_3, SO_4, Ca, Na , etj., nga të cilët tre të paret vijnë nga procesi i reduktimit të sulfatave në prani të lëndës organike.

Abstrakt

Gjatë viteve 1960-1990 janë marrë dhe analizuar një numër shumë i madh provash uji nga puset Për pasojë është grumbulluar një material i shumtë. Për më tepër, numri i treguesve të analizuar është rritur vazhdimisht nga koha në kohë. Kështu, përvëç komponentëve kryesor: $Ca^{2+}, Mg^{2+}, Cl, SO_4^{2-}, CO_3^{2-}, HCO_3^-$, më vonë janë përcaktuar edhe mikroelementët Jod, Brom, Bor, dhe NH_4 , por edhe H_2S , Stroncium, Litium, etj. Krahas tyre, përcaktimet e lëndës organike të tretur në ujëra, si acidet naftenike, karboni organik, karboni organik bituminoz, fenollet, oksidueshmëritë jodate dhe permanganate, benzeni e homologet e tij, etj., kanë plotësuar kështu gjithë treguesit e mundshëm hidrogeokimik, karakteristike të bashkëveprimit ujë - shkëmb - hidrokarbure. Në artikull jepen disa nga aspektet kryesore hidrogeokimike të ujrade të vendburimeve të naftës; aspektet gjeokimike mbështetur vetëm në përbajtjen e benzenit dhe homologeve të tij në ujra, kriteret e aplikimit të tyre në kërkimin e naftës dhe aspektet hidrokimike mbështetur në disa nga treguesit kryesor të larëpermendor.

Literatura

- Dhimulla, I. etj.** 1987 "Konditat historiko-gjenetike të formimit të shtratimeve të naftës e gazit në shkëmbinjtë karbonatë të zonës Jonike". F.I.Gj.N. Fier "Kriteret gjeokimike të vlerësimit perspektiv të depozitimeve karbonatike në brezin e Kurveleshit". Disertacion për kërkimin e gradës "Kandidat i Shkencave".
- Xhemalaj, XH. Çurri, F.** 1990 "Konditatt hidrogeologjike të brezit të Kurveleshit dhe perspektiva naftëgazmbajtëse e tij në dritën e studimeve hidrogeokimike, hidrogeokimike e hidrodinamike ". F.I.Gj.N., Fier "Hidrogeologia e rajonit të vendburimeve karbonatike dhe kriteret hidrogeologjike të vlerësimit të perspektivësnaftëgazmbajtëse". Disertacion për kërkimin e gradës "Kandidat i Shkencave".
- "Mbi studimin e benzenit dhe të homologëve të tij të tretur në ujërat e naftës" Nafta dhe Gazi, Nr. 2, "Shpërndaja e benzenit dhe homologëve të tij në ujërat e vendburimeve të naftës dhe kriteret e përdorimit në kërkimin e naftës" Nafta dhe Gazi, Nr.1, "Aspekte hidrodinamike të karbonatike të naftës të Shqipërisë", Nafta Shqiptare, Nr.2,
- Xhemalaj, XH., Bushi A., Bucka, L.** 1986 2000

Tole, N. Xhemalaj, XH., Como, L 1985
Xhemalaj XH., Bushi A., 1986
Bucka, L.

Xhemalaj, Xh. vendburimeve

2000

"Aspekte hidrodinamike të

karbonatike të naftës të Shqipërisë", Nafta

Shqiptare, Nr.2,

Abstract

The amounts of dissolved constituents found in subsurface waters can range from a few milligrams per liter to more than 100 000 mg/lit. This salinity distribution is dependent upon several factors, the genesis of waters, depth of occurrence, distance from the outcrops, mobility of the dissolved chemical elements, soluble material in the associated rocks, and the exchange reactions. Always, there is an oil - water - rock interaction expressed in the composition of oilfield waters with the amounts of dissolved constituents found in subsurface waters.

The constituents determined for most of the brines include sodium, potassium, calcium, magnesium, strontium, boron, chloride, bromide, iodide, bicarbonate, carbonate, sulfate, ammonium, lithium, hydrocarbons, etc.

The first aspect treated in this paper is the distribution of benzene and its homologues in oilfield waters, because they are considered the most important and direct indicators of petroleum accumulation in a formation.

The amount of benzene in oilfield waters depends upon the type of petroleum, contents of aromatic hydrocarbons in petroleum, density of oil, and the location conditions of these waters as, the depth, temperature, salinity, etc. If the concentration of a measured aromatic hydrocarbon in a sample of formation water is equal to a target value, the point from which the sample was obtained is close to a reservoir of crude oil. Greater differences between these two values represent greater distance to the crude oil accumulation. The target value is function of oil and water properties found in the area.

Another important aspect is water - rock interactions expressed on composition of oilfield waters with the amounts of dissolved constituents found in subsurface waters. Oilfield waters are characterized by a chemical composition that classifies them in different types. It depends upon the amounts and the ratios of these constituents found in water. They reflects the origin of the water, water - rock interaction during long time spans and the geological processes that may have been occurred to the water since entering the subsurface environment.

Before one discusses the genesis of a brine, it is worthwhile to remember that the history of a water mass is expressed, in a way or other, on its dissolved constituents. Bromine, for example, is considered to be the most conservative ion in evaporating seawater. Thus, if evaporated seawater were the precursor of these brines, its composition could be deduced from bromine concentrations. The plot $\text{Br} = f(\text{Salinity})$ is an example of finding what has occurred to the water as a result of regional „tectonometamorphic“ processes.

Oilfield waters are characterized by a wide range of the amounts and ratios of their constituents. Oilfield waters are found in not so different hydrogeological and geochemical conditions, but they will change from other waters that are far from oil fields. This is expressed by presence of hydrogen sulfide, biogenic nitrogen, an enrichments of other biophile elements like as J^- , Br^- , B^{3+} , K^+ , and the degree of sulfate reduction. Discriminant analyses realized for the water of crude oil accumulation and the water that are far away these accumulations give this change expressed in some indicators like HCO_3^- , SO_4^{2-} , etj.

DEPOZITIMET E TRIASIKUT TË POSHTËM NË PORTAT E SHALËS (DUGAGJIN)

Vangjel KICI

Në sektorin Portat e Shalës (Lotaj) deri tani jepet prania e depozitimeve të permianit. Në jug të sektorit jepen depozitimet flishore të Cukalit me moshë mafriktian i sipërm - paleocen-eocen, që vazhdojnë mbi gjëqerorët e kretakut të sipërm. Në veri të sektorit takohen depozitimet e triasikut të poshtëm dhe të mesëm.

Nga studimet e kryera rezulton se nuk ka depozitime flishore. Ato janë shistet xhani të eocenit të mesëm-sipërm, që shtrihen discordant (Gjani Schiefer sipas Nopcsa F., 1929). Depozitimet e permianit nuk takohen në Portat e Shalës. Ato janë depozitimet e triasikut të poshtëm.

HYRJE

Nga fundi i shtatorit deri në fillim të tetorit 1992 u kryen vrojtime gjeologjike dhe një prejje stratigrafike në Lotaj – Portat e Shalës (Fig.1). Këto punime u kryen nga autorë dhe Ing. Gjeolog. I. Doçi. Ky i fundit meriton bashkëautorësinë në këtë artikull, por për mungesë kontakti nuk kemi munur të marrim miratimin e tij.

Qëllimi i punimeve ishte marija e disa të dhënave për sqarimin e mardhënieve ndërmjet Alpeve Shqiptare dhe Cukalit, veçmim e shisteve Xhani me vendosje diskordante nga flishi i prerjes së vazhdueshme të Cukalit dhe nga depozitimet e triasikut të poshtëm. Synimi ishte gjithashu marija e një teme stratigrafike për brezin kufitar Alpe – Cukal etj. Në këtë artikull paraqiten disa të dhëna të reja. Kjo është e nevojshme, sepse pëkkëtë rajon vazhdon të ruhet mendimi i vjetër gjeologjik, që shprehet edhe në Hartën e re Gjeologjike të Shqipërisë në shkallen 1: 200 000.

NDËRTIMI GJEOLOGJIK I SEKTORIT PORTAT E SHALËS

Sipas të dhënave të deritanishme, në ndërtimin gjeologjik të sektorit marrin pjesë depozitimet e permianit, triasikut të poshtëm dhe të mesëm (zona e Alpeve Shqiptare) dhe në zonën e Cukalit kanë përhapje depozitimet karbonatike të triasikut të sipërm – jurasikut dhe kretakut. Me vazhdimësi jepen depozitimet “flishore” të mafriktinanit të sipërm – paleocenit dhe eocenit (fig. 2a).

Në fakt, nga pumimet e kryera, rezulton se në këtë sector depozitimet e permianit mungojnë.

Depozitimet e konsideruara “flishore” nuk janë fish, por janë “shistet Xhani” (Gjani Schiefer sipas Nopcas, 1929). Këto shiste argjilore me olistolite shtrihen discordant mbi formimet më të vjetra (fig. 2b). Moshë e këtyre duhet të jetë eocen i mesëm – i sipërm, sepse në rajonin Lekbibaj janë takuar Discocyclina cf. marthae, D. cf. nummulitica, Asterocydina Cuvillieri, Nummulites spp. etj. (Myftari A. etj., 1986). Shistet Xhani mbulojne thyerjen e thelle tektonike ndermjet Alpeve shqiptare dhe Cukalit.

Mardhëni e shisteve Xhani me depozitimet e triasikut të poshtëm fillimisht janë diskordante, por në sektorin e “Portave të Shalës” këto nuk janë të qarta, sepse ka mbulesa. Në veri të “Portave të Shalës” shistet Xhani shtrihen, në të dy shpatet e luginës së lumit të Shalës, mbi depozitimet e triasikut të poshtëm, që dalin poshtë anë të xhades. Pra në luginën e lumit të Shalës, në nivelet më të thella erozonale takohen depozitimet e triasikut të poshtëm (skithian) me pamje “flishore” dhe jo fishi mafriktian – eocenit i Cukalit, që mendohet gabimisht se ndodhet poshtë Alpeve Shqiptare të

mbihipur tektonikisht drejt jugut mbi Cukal (Qirinxhi etj 1983, Grillo etj 1986, ISPQJ 1990). Shiset Xhani takohen edhe sipër në fshatin Nicaj Shala (në lindje të Breglumit). Këtu në një shtresë ranori pranë rrugës këmbësore, takohen Paleodictyon. Këto në zonën tektonike të Kruiës dhe në atë Jonike takohen vetëm në depozitimet flishore të paleogenit (eocen-oligocen). Ky fakt dhe karakteri litologjik i njëjtë me shiset Xhani përfashton moshën triasike të poshtme dhe mbështet moshën terciare të këtyre depozitimeve, që janë shiset Xhani. Këto shiste edhe në veri të Kirit (Lekgjonaj) takohen në kuota të larta mbi depozitimet e termianit, por janë konsideruar si "dritare tektonike e flishit të Cukkalit" (Qirinxhi etj, 1983). Mardhënet e këtyre shisteve me depozitimet triasike dhe fushëpërhapja e tyre këtu në thellësi të Alpeve kërkojnë verifikime dhe plotësimë të hartës gjeologjike. Rezultatet e pritshme do të ndryshojnë përfytyrimin mbi ndërtimin gjeologjik të rajonit Alpe-Cukal.

Sidoqoftë, avancimi i shisteve Xhani kaq në thellësi të Alpeve tregon për mundësinë e shtrijes së tyre discordant mbi depozitimet e triaskut të poshtëm.

PAK FJALË MBÌ DEPOZITIMETE PERMIASIT

Në rajon takohen depozitimet e permianit, përcaktuar për herë të parë nga Nopcca (1929). Ato shtrihen në formën e një brezi në afersi të fshatit Xhan në perëndim drejt fshatit Lekbibaj në lindje. Depozitimet e permianit janë paraqitur në të gjitha hartat gjeologjike (Harta Gjeologjike e Shqipërisë 1983, Qirinxhi A. etj., 1983, Myftari A. etj., 1986 etj). Vetëm në hartën gjeologjike 1:25 000 të V.Grillo etj. (1983) në sektorin portat e Shalës, në vend të depozitimeve permiane me të drejtë jepen depozitimet e triaskut të poshtëm. Interesant është fakti që grupi i studimit të stratigrafisë së depozitimeve palozoike (Xhomo A. etj., 1985) në sektorin portat e Shalës gabimish jep prejëne permianit. Edhe në Hartën e re Gjeologjike të Shqipërisë në këtë sektor jepen depozitimet e permianit. Këto fakte nuk qëndrojnë prandaj duhen bërë korrigimet e nevojshme.

Në ekstremin perëndimor të sektorit dhet më tej (Guri i Kunores-Pog) dhet në lindje të sektorit drejt Lekbibajt dalin në sipërfaqe depozitimet e permianit. Në sektorin e Portave të Shalës depozitimet permiane mund të vazhdojnë posht shisteve Xhani dhe pa dyshim posht depozitimeve të triaskut të poshtëm, prandaj ato nuk dalin në sipërfaqe. Sidoqoftë, për këtë problem harta gjeologjike ka nevojë për verifikime dhe plotësimë. Duhet theksuar se me konceptin e deritanishëm (Alpet janë të ardhur mbi Cukal) depozitimet e permianit mendohet se vazhdojnë vetëm nën Alpe. Faktikisht ato duhet të vazhdojnë edhe nën Cukal (Kici V., 1999).

DEPOZITIMET E TRIASKUT TË POSHTËM

Këto depozitime janë objekti kryesor i këtij studimi. Këtu nuk do të jepet përshtrimi i hollësishëm litologjik, sepse ky përshtrim eshtë bërë në studimin e stratigrafisë së paleozoikut për depozitimet e konsideruara si të permianit (Xhomo A. etj., 1985). Këtu do të jepen disa karakteristika kryesore. Mbështete Xhani, që kanë rënien veri-verilindore me azimuth rënien 5-30 gradë dhe kënd rënien 30-50 gradë ose rënien 45-60 gradë dhe kënd rënien 30-50 gradë, takohen depozitimet e triaskut të poshtëm. Ato janë depozitime me pamje flishore argilo-gëlqerore (ndërrhujse ritmike) dhe në fillim kanë rënien veri-veriperëndimore me azimuth rënien 330-350 gradë dhe kënd rënien 25-60 gradë, kurse drejtërimi i depozitimet kanë rënien veri-verilindore me azimuth rënien 5-30 gradë dhe kënd rënien 25-45 gradë (njëloj si shiset Xhani). Kontakti ndërmjet shisteve Xhani dhe depozitimeve të triaskut të poshtëm nuk është i qartë, sepse ka mbulesa. Ky kontakt ndodhet afersisht praen urës mbi lumen e Shalës. Argjilat janë shistoze, gri deri të zeza. Kanë trashësi nga centimetrike deri 10-30cm e më tepër. Aty këtu përbajnjë copra – linza gëllqerori plakore ose biloqe qëlleroresh.

Me shiset argjilore ndërthuren shtresa gëllqerori kryesisht plakore, grid he të zini, më rrallë shtrësë mesem – trashë deri massive, që shuhën në terren. Ato kanë trashësi të dukshme 2.5m, 7m dhe 10m.(fig.3)

Tek Portat e Shalës takohet një paketë gëllqerorësh massive me trashësi rreth 50m. Këtajanë gëllqerorë grid he të errët deri të zini, massive dhe konglobreckore, që ndërthuren.

Në veri të Portave të Shalës vazhdojnë rreth 150m depozitime ritmike me karakter flishor argilo – gëlqeror. Argjilat janë shistoze gri deri të zeza, kurse gëllqerorët janë plakore, gritë errët dhe të zini. Më tej Breglumi prejë vazhdon, por ka shumë mbulesa.

Gëllqerorët në përgjithësjanë të rikristalizuar dhe pa mikrofositë. Rullat në shtrësatsat gëllqerore, poshtë dhe sipër gëllqerorëve të Portave të Shalës janë takuar Meandrospira pusilla. Këto, si dhe karakteri flishor i depozitimeve me gëllqerore plakore të zini, dëshmojnë për moshën triasik i poshtëm(Pezza L.H etj 1973).

Duhet theksuar se në depozitimet e triaskut të poshtëm takohen në disa nivele rrëshqitjet nenujore me trashësi 3-5m secila. Njëranga këto ndodhet rrith 15m nëngëllqerorin masiv të Portave të Shalës dhe shquhet mmirë në terren (fig.3-4). Ajo shihet bukur nga xhadeja në anën perëndimore të lumit të Shalës dhe del në anë të rrugës automobilistike. Rëshqitjet nenujore ndodhen ndërmjet depozitimeve më rënien monoklinale veriore dhe përfaqësohen nga masa argjilore të rrëshqitura, rrudhosura dhe shtrësa gëllqerori plakore të rrëshqitura dhe të rrudhosura në antiklina dhe sinklina të vogla. Planet aksiale të antiklinave dhe sinklinave kanë elementet e rënies 120-130/40gradë ose 130/30gradë. Sikurse shihet, planet aksiale kanë rënien juglindore dhe kjo tregon rënien e shpatit në fundin e basenit gjatë kohës së formimit të depozitimeve të triaskut të poshtëm.

Pra, depozitimet e triaskut të poshtëm, që tanë kanë rënien monoklinale veri-veriperëndimore deri veri-verilindore, në kohëne formimit të tyre kanë pasur rënien afersisht juglindore (drejt Cukkalit). Baseni i cekët detar me Meandrospira i Alpeve thellohej drejt Cukkalit. Kjo është një e dhënë e re, sepse depozitimet e triaskut të poshtëm në Cukal nuk dalin në sipërfaqe (Theodhori P. etj., 1978).

PËRFUNDIMË

1. Në sektorin e Portave të Shalës depozitimet që janë dhënë me moshë permiane janë të Triaskut të poshtëm. Depozitimet e permianit këtu nuk dalin në sipërfaqe.
2. Depozitimet "flishore" të Cukkalit me moshë mastrihtian i sipërm – paleocen – eocen, që janë dhënë si vazhdim i prerjes, faktikisht janë shiset Xhani të bocenit të mesem – sipërm me vendosje diskordante.
3. Në Nicaj Shala (në lindje të Breglumit) takohen shiset Xhani në kuota të larta. Atom und të shtrihen discordant mbi depozitimet e triaskut të poshtëm të bllokut të Alpeve shqiptare, por kjo duhet verifikuar në terren.
4. Këshiqjet nenujore në Portat e Shalës tregojnë për një shpat nëndetar më rënien afersisht juglindore (drejt Cukkalit), gjatë formimit të depozitimeve të triaskut të poshtëm. Këto depozitime tanë kanë rënien të kundërt (veri-veriperëndimore).

LITERATURA

- | | | |
|--|--------------|---|
| Grillo V, Turku I.
Bakri S, Nikoll M. | 1983
e | Studim tematiko-përgjithësues e rilevues për kërkimin polimetaleve në rajonin Dukagjin – Vermosh (për vitet 1981-1982). Fondi I.S.P.GJ, Tiranë. |
| I.S.P.GJ, I.N.G
I.S.P.GJ, I.N.G | 1983
1990 | Harta Gjeologjike e RPSh në shkallë 1:2000000.
Gjeologjia e Shqipërisë (tekst sqarues i Hartës |

NEKROLOGJI

Gjeologjike
Tiranë 1983)
Kici V.

të R.P.S të Shqipërisë në shkallë 1:200000.
Shqipërinë veriperëndimore . Bul.Shkenc. ne

Gjeol. Nr.2.
Kici V.
ship

Sep
Kici V.

dhe
Shqiptare, Nr.2.
Myftari A. Hamiti S,
në Xhomox A, Pirdeni A, Terolli I, Hyka B,
I.S.P.GJ, Mazrekut A, Kospiri A.
Nopcsa fr.

1998 New geological ideas on the Alps – Cukali relation-
and the orebearing perspective. Carpathian – Balkan
Geological Association, XVI Congres, August 30th to
tember 2nd, Vienna. (Abstract)

1999 Ide të reja gjeologjike mbi mardhëniet Alpe-Cukal
perspektivën mineralmbajtëse. Nafta

1986 Studim mbi punimet e kërkim – rilevimit kompleks
shkallë 1:250000 në rajonin e Lekbibajt. Fondi
Tiranë.
Peza L.H, Xhomox A,
Alpeve Theodhori P, Jahja B, Gjoshi Sh.
Qirinxhi A, Bicaj Z, Tashko A,
të rajonit Kosho P, Bushati S, Monika K, Kastrati N.Kir – Ndreaj – Brashtë. Fondi I.S.P.GJ, Tiranë.
Theodhori P, Bushati Sh, Pirdeni A. 1978 Stratigrafia e depozitimeve të zonës së Cukalit dhe
disa

Tiranë.
Xhomox A, Pashko P, Mecco S. 1985 Stratigrafia e depozitimeve paleozoikë të Albanideve
të
lidhen me

ABSTRACT

Till now in the “Portat e Shalës” sector (Fig.1,2) it is given the presence of Permian deposits. On the southern part of the sector, there are given flysch deposits of Cukali zone (upper Maastrichtian – Paleocene – Eocene age). They continue upéard of upper Cretaceus limestones. On the Northern part of the sector the lower and middle Triassic deposits are encountered. By the studies done, the Permian deposits are resulted to be not encountered in “Portat e Shalës” sector. There are founded the lower Triassic deposits with Meandropspira pusilla(Fig 2b). The Permian deposits are encountered on the eastern and western part of “Portat e Shalës” sector. The flysch deposits are also absent. These are Xhani schists (middle – upper Eocene age), which are discordantly located(Gjani Schiefer after Nopcsa F, 1929). These schists cover the deep tectonic fault betéen Albanian Alps and Cukali zone.

Haki CASLLI lindi në Tiranë më 1935. Bir i një familje të vjetër, të ndershme dhe patriote tiranase, ai u mbrijt me cilesitë më të vjera të popullit tonë. Me përfundimin e studimeve të larta në vitin 1959, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minerave të Universitetit të Tiranës, inxhinier gjeologu i ri filloj menjherë punën në Ndërmarrjen Gjeologjike të Kukësit. Për punë cilësore dhe rezultative, shumë shpejt u emërua në detyrën e Kryegjeologut të kësaj ndërmarrjeje dhe me pas u transferua në Institutin e Kërkimeve Gjeologjike, ku për një kohe të gjatë drejtoi Kabinetin Metodik të ketij Instituti.

Haki CASLLI gjatë jetës së tij aq njëherë nuk ju shmang përgjegjësive, përkundrazi kur i besohej një detyrë e kryente atë me pasion, këmbengujse dhe me ndershmeti të lartë, pamvarësishë vështirësive të shumta. Veprimtaria e tij shkelqeu gjatë shumë viteve, kur Ai drejtoi Ndërmarrjen Gjeologjike të Bajram Currit. I transferuar nga Instituti i Kërkimeve Gjeologjike në këtë ndërmarrje në vitin 1975, Haki u vajti atje, bashkë me familjen e tij. Ai arriti rezultate të larta në kërkim – zbulimin e mineralit të kromit dhe ajo që ishte më e rëndësishme e pojisë ndërmarrjen me laborator të ri dë ekipë gjeologësh të talentuar tropojnë që projektonin e zbatonin me sukses kërkimin e zbulimin e mineralevë të dobishme të rrethit të Tropojës. Kulmin e veprimitarës, Haki CASLLI e pati kur drejtoi Drejtorinë e Përgjithësme të Gjeologjisë në Ministrinë e Industrisë dhe Minierave (1980 – 1987). Nën udhëheqjen e tij Shërbimi Gjeologjik u fuqizua dhe arriti rezultate të mira në kërkim-zbulimin e mineralevë, që ndikuau direkt në rritjen me ritme të shpejta të prodhimit në minierat e kromit, të bakrit, qymyreve etj, dhe lulëzimit maksimal të industrisë së rendë.

Haku nxiti dhe mbështeti fitjen e metodave dhe metodikave të reja. Një gjë të tillë Ai e inkurajoi edhe kur u transferua në Qendrën Gjeofizike të Tiranës pas një operacioni të vështirë që bëri në vitin 1986. Edhe këtu, Haku u shqua për preokupacionin dhe përpjekjet për të kontribuar në maksimum në përmirësimet metodikë të kërkimin e kromiteve. Haki CASLLI e ka përfaqesuar denjësisht Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në aktivitetë të ndryshme shkencore në vendin tonë dhe në disa vende të botës dhe njëkohësisht i ka krijuar mundësitë shumë shkencëtarëve me përvojë dhe të rinj që të shpalosnin idetë e tyre në aktivitetë të tillë.

Por, Haki CASLLI nuk ishte vetëm një specialist dhe drejtues i talentuar. Mbi të gjitha Ai ishte një bashkëshort dhe prind shembullor dhe shok e mik i shtrunjë dhe i respektuar i shumë gjeologëve, sondistëve, minatorëve, etj. në të katër anët e vendit. Të gjithë e donin, dhe për këtë mjafton që të përmendim që në Bajram Curri atë e thërrisin “Baca Haki” si njeriun e dashur të tyre. Haku ndrroi jetë më 15 Tetor 2001. Jeta dhe veprat e Haki CASLLIT do të jenë shembull për gjeologët e rinj.

T. Biçoku H. Beshku, M. Zaçaj,
I. Premti, R. Shehu, K. Gjata, H. Hallaci,
V.Gjoni, P. Vaso, A. Kodra, F. Arkaxhiu, M. Dardha

Inh. Gjeolog. Haki CASLLI

Inxh. Gjeolog. Skënder Hoxha

Skënder Hoxha ka lindur në Pogradec më 10/09/1951. Fëmijërinë, shkolën 8-vjeçare e të mesme i kreu në qytetin e Maliqit. Në vitin 1973 përfundoi studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Gjeologji Miniera ku u diplomua Inxhimer Gjeolog.

Mbas një periudhe të shkurtër pune si gjeolog zbulues në vendburimit e hekur-nikelit në Bushtricë, Librazhd, përfshirë profesionale dhe vullnetin që e karakterizonin u emërua pedagog në Shkollën e Mesme Gjeologji-Miniera, Prrenjas ku puna me nivel shkencor, kultura edukative dhe kujdesi atëror spikaten gjatë periudhës 9 vjeçare të punës së tij në atë shkollë.

Në vitin 1982 e në vazhdim Skënder Hoxha u rikthye në ndërmarrjen gjeologjike të Pogradecit si gjeolog rilevues në masivin ultrabajzik të Shebenik-Pogradecit e më pas si gjeolog zbulues në vendburimet e argjilave të zonës së Alarupit, vendburimet e kromit Çervenakë, Pojskë, Guri i Pëllumbit, Bregu i Pishës, Shesh Bush, Bushtricë, Ozunet etj.

Dhjetra projekte, raporte e studime shkencore të dala nga dora e Skënderit janë kontribut i tij shkencor për brezat e ardhshëm.

Puna e Skënderit ka qenë shumë aktive dhe mbas viteve 1990, vite kur ai me profesionalizëm punoi në grupin e përgjithësimit të ndërmaries për vendburimet e kromit, dhe më pas si gjeolog në kërkim-vlerësimin e gurëve dekorativë, materialeve të ndërtimit apo perspektivës krom mbajtëse të masivit të Shebenik-Pogradecit.

Pasiioni i madh për punën, korrekta e urtësia me shokët, sedra profesionale dhe këmbëngulja për të çuar punën deri në fund bënë që shoku, miku dhe kolegu ynë, Skënderi, të mos shkëputëj nga puna dhe ditën e fundit të jetës. Përpjekjet e jashëzakonskume të Skënderit për të përtalluar sëmundjen nuk mundën ta mbanin më atë midis nesh. Skënderi do të mbetet në kujtesën e shokëve, miqve dhe ish nxënësve të tij, si një ndër kolegët, miqtë e pedagogët më të mirë.

Me ndarjen ngajeta të Skënderit familiJA humbi njeriun më të dashur të saj, kurse shoket e miqtë një nga bashkëpunëtorët më të mirë.

H. Beshku, K. Gjata, H. Hallaci, V.Gjoni
P. Kita, H. Roqi, K. Spirollari, V. Pine,
V.Shehaj, S. Plaku, J. Adhami, Z.
Zeqollari, A. Muça, A. Hamzallari, A.
Kajacka, Sh. Gegë, F. Blaceri, B. Qatipi,
A.Pilinci, R. Babasuli, K. Gegprifti, V.
Drago, P. Pavliqi R. Xhafka